

UNIVERSITETI I EJL
УНИВЕРЗИТЕТ НАЈМЕ
SEEUNIVERSITY



FAKULTETI JURIDIK
ПРАВЕН ФАКУЛТЕТ
LAW FACULTY

STUDIMET PASDIPLOMIKE - CIKLI I DYTË

DREJTIMI: E DREJTA CIVILE

TEZA:

**DETYRIMI PËR MBAJTJE NDAJ BASHKËSHORTIT DHE FËMIJËVE ME FOKUS NË
LEGJISLACIONIN E REPUBLIKËS SË MAQEDONISË SË VERIUT**

KANDIDATI:
Ajnure EMINI

MENTOR:

Doc. dr. Albana METAJ-STOJANOVA

Tetor 2023

DEKLARATË

Unë, Ajnur EMINI nën përgjegjësinë time personale, deklaroj se përmbajtja e temës së magistraturës së paraqitur: **“DETYRIMI PËR MBAJTJE NDAJ BASHKËSHORTIT DHE FËMIJËVE ME FOKUS NË LEGJISLACIONIN E REPUBLIKËS SË MAQEDONISË SË VERIUT”** është punë origjinale e shkruar prej meje, e cila nuk është prezantuar asnjëherë para ndonjë institucioni tjetër për vlerësim dhe nuk është botuar e tërë ose në pjesë të veçanta të saj. Të gjitha referencat dhe citimet në tekst janë bërë në bazë të burimeve të paraqitura në fusnota, universitetit i barten të drejtat autoriale të punimit, për përdorim për qëllime edukative-arsimore dhe hulumtuese.

Me respekt

Ajnure Emini Loki

()

PËRMBAJTJA

PËRMBAJTJA	3
ABSTRAKT	5
HYRJE	8
1. ZHVILLIMI HISTORIK DHE KUPTIMI AKTUAL I DETYRIMIT PËR MBAJTJE.....	15
1.1.Trajtimi historik i detyrimit të mbajtjes, gjeneza e tij	15
1.2.Trajtimi historik i detyrimit të mbajtjes sipas legjislacionit të ish Jugosllavisë	17
1.3.Kuptimi dhe karakteristikat e mbajtjes sipas Ligjit për familje të Republikës së Maqedonisë së Veriut.....	19
1.4.Parimet themelore të mbajtjes financiare	21
1.5.Veçoritë e detyrimit për mbajtje	22
2. DETYRIMI PËR MBAJTJE NDAJ BASHKËSHORTIT DHE FËMIJËVE SIPAS LEGJISLACIONIT TË REPUBLIKËS SË MAQEDONISË SË VERIUT	24
2.1.Mbajtja e bashkëshortit.....	24
2.2.Kërkesa për mbajtje	26
2.3.Përcaktimi i mbajtjes	27
2.4.Kohëzgjatja e mbajtjes.....	29
2.5.Pushimi i mbajtjes	30
2.6.Mbajtja e fëmijëve nga prindërit e tyre	31
2.6.1. Mbajtja e fëmijëve të mitur	32
2.6.2. Mbajtja e fëmijëve të moshës madhore	32
2.6.3. Përcaktimi i mbajtjes.....	33
3. DETYRIMI I MBAJTJES NË KËNDVËSHTRIM KRAHASUES.....	35
3.1. Nocioni i mbajtjes sipas Ligjit për familje të Kosovës	35
3.2. Detyrimi i mbajtjes midis bashkëshortëve.....	37
3.3. Detyrimi i prindërve për t'i mbajtur fëmijët	38
3.4. Detyrimi për ushqim sipas Kodit të familjes të Shqipërisë.....	40
3.5. Detyrimi për ushqim midis bashkëshortëve	41
3.5.1. Heqja, pakësimi ose shtimi i detyrimit për ushqim	42
3.5.2. Mënyra e përmbushjes së detyrimit për ushqim	43
3.6. Detyrimi për ushqim i prindërve ndaj fëmijëve	44

3.7. Nocioni i mbajtjes sipas të Drejtës italiane	45
3.7.1. Detyrimi i mbajtjes së prindërve ndaj fëmijëve	47
3.7.2. Detyrimi i mbajtjes midis bashkëshortëve	48
4. ROLI I ORGANEVE SHETETËRORE NË ZBATIMIN E DETYRIMIT TË MBAJTJES	50
4.1. Roli i gjykatës në zbatimin e detyrimit të mbajtjes	50
4.2. Gjykata supreme në zbatimin e detyrimit të mbajtjes	52
4.3. Roli i Qendrës për punë sociale në zbatimin e detyrimit të mbajtjes	53
4.4. Raste nga praktika gjyqësore	56
4.5. Të dhëna nga anketat dhe intervistat e realizuara	61
4.5.1. Intervistat	61
4.5.2. Anketa	64
PËRFUNDIME	Error! Bookmark not defined.
BIBLIOGRAFIA	74
Libra, revista:	74
Akte ligjore, kode:	79
Burime nga Interneti:	80

ABSTRAKT

Detyrimi për mbajtje të bashkëshortëve dhe fëmijëve është segment, apo thënë ndryshme një veprim i tillë është i paraparë me legjislacionin e vendit tonë, që pa dyshim ka për qëllim të ju dale në ndihmë palës më të dobët ose ajo që ndryshe do quhej mbrojtja e të drejtës së bashkëshortëve dhe fëmijëve për të marrë atë që ju takon çdonjërit prej tyre.

Tema të ngjashme janë punuar edhe më herët në forma të ndryshme duke prekur segmente të ndryshme, por për ne ishte njëra ndër arsyt kryesore që të bëhet një punim i këtillë që do ndihmonte në të ardhmen për një qasje edhe më të mirëfilltë.

Në këtë punim kemi startuar me historikun e mbajtjes së bashkëshortëve si pjesë kyçe për të vazhduar në të me nënkapitujt e tjerë.

Brenda punimit kemi shfrytëzuar metoda të ndryshme, duke shpresuar që nëpërmjet këtyre metodave të arrijmë deri në përfundime sa më të sakta dhe më precize.

Edhe pse gjatë punimit do të hasim në disa problematika të cilat do të kërkojnë zgjedhje dhe konsultime të shumta, me libra të ndryshëm në fusha edhe të tjera që në njërin formë ose tjetrën lidhen tërthorazi me temën tonë, dhe atë jo vetëm në gjuhën tonë por edhe në gjuhë të tjera botërore.

Gjatë punimit më është dashur të shfrytëzoj literaturë nga gjuha shqipe, maqedonase, serbe, kroate, angleze, turke, etj.

Fjalë kyçe: *detyrimi për mbajtje ndaj bashkëshortit, detyrimi për mbajtje ndaj fëmijëve, përcaktimi i mbajtjes, kohëzgjatja e mbajtjes*

АБСТРАКТ

Обврската за одржување на сопружниците и децата е сегмент, или поинаку кажано, ваквото постапување е предвидено со законодавството на нашата земја, кое несомнено има за цел да и помогне на послабата страна или она што инаку би се нарекло заштита на правото на брачните другари. а децата да го добијат она што му следува на секој од нив.

На слични теми се работеше и порано во различни форми кои зафаќаа различни сегменти, но за нас тоа беше една од главните причини да се направи една ваква работа која во иднина ќе помогне за уште по буквален пристап.

Во овој труд, започнавме со историјата на чувањето на сопружниците како клучен дел за да продолжиме со другите под поглавја.

Во рамките на трудот користевме различни методи, со надеж дека преку овие методи ќе дојдеме до најточни и најпрецизни заклучоци.

Иако во текот на работата ќе најдеме на некои проблеми кои ќе бараат многу избори и консултации, со различни книги од други области кои во една или друга форма се индиректно поврзани со нашата тема, и тоа не само на нашиот јазик, туку и на другите светски јазици.

Во текот на работата морав да користам литература од албански, македонски, српски, хрватски, англиски, турски итн.

Клучни зборови: *обврска на издршка спрема брачниот другар, обврска на издршка спрема деца, одредување на издршка, времетраење на издршката.*

ABSTRACT

The obligation to maintain spouses and children is a segment, or to put it differently, such an action is foreseen by the legislation of our country, which undoubtedly aims to help the weaker party or what would otherwise be called the protection of the right of spouses and children to receive what is due to each of them.

Similar topics have been worked on earlier in different forms affecting different segments, but for us it was one of the main reasons to do such a work that would help in the future for an even more literal approach.

In this paper, we started with the history of keeping spouses as a key part to continue with the other sub-chapters.

Within the paper, we have used different methods, hoping that through these methods we will reach the most accurate and precise conclusions.

Although during the work we will come across some problems which will require many choices and consultations, with different books in other fields that in one form or another are indirectly related to our topic, and not only in our language but also in other world languages.

During the work, I had to use literature from Albanian, Macedonian, Serbian, Croatian, English, Turkish, etc.

Keywords: *maintenance obligation towards the spouse, maintenance obligation towards children, definition of maintenance, duration of maintenance.*

HYRJE

Martesa paraqet një institut tejet të vjetër sa edhe vetë njerëzimi. Mund të thuhet se ajo daton që nga krijimi i vetë njerëzimit respektivisht krijimi i Adamit dhe Evës apo Ademit dhe Havës siç njihet në të drejtën islame. Edhe pse atë botë martesa nuk është njohur si formë apo si institut sikurse filloi të njihet më vonë, megjithatë ajo ka ekzistuar si bashkim i dy personave me gjini të kundërt të cilët parimisht janë krijuar për të shumuar racën njerëzore, e kështu më pas për të plotësuar edhe qëllimet e tjera jetësore. Duke kaluar vitet e duke u shtuar njerëzimi, shumë gjëra filluan të ndryshohen e të marin kahje të tjera nga fillimi i tyre. Martesa më nuk njihej vetëm si bashkim mes dy personave me gjini të kundërt, por edhe si formë edhe si institut në vete me veçoritë e me qëllimet e veta. Kronologjikisht, ajo filloi të pasojë edhe forma të tjera pas vetes siç është *divorci* që në kohërat e hershme nuk ka ekzistuar fare, por që me kalimin e kohës filloi të paraqitet si dhe të aprovohet në shoqëri. Vlen të theksohet se në fillimet e paraqitjes së tij, disa të drejta nuk e pranonin si të tillë e ajo ishte E drejta kanonike, megjithatë me kalimin e kohës filloi të aprovohet në shoqëri nga të gjitha të drejtat, kështu duke u hapur rrugën edhe disa formave të tjera të kohës moderne siç janë martesa e kontraktuar, bashkësia jashtëmartesore e kështu me rradhë.

Sikurse martesa edhe divorci paraqet një institut të vjetër që daton që nga kohërat e lashta i cili ka pasuar martesës. Edhe divorci ka karakteristikat e veçoritë e tij siç janë shkaqet që çojnë deri në divorc, pasojat që paraqiten në rast të divorcit siç janë darja e pasurisë mes bashkëshortëve, marrja e kujdestarisë së fëmijëve, mbajtja e bashkëshortit dhe fëmijëve term ky i cili do të zbërthehet më gjerësisht në vijim etj.

Meqenëse tema e cila do të trajtohet në këtë punim ka të bëjë me detyrimin e mbajtjes së bashkëshortit të pasiguruar dhe fëmijëve, në vijim do të trajtohet më gjerësisht edhe atë në aspekt krahasues mes kohës së kaluar dhe të tanishmes si dhe mes vendeve të ndryshme në raport me legjislacionin e RMV-së.

Në një shtet si shteti ynë një temë e këtillë është shumë e prekur dhe mund të themi se nga ajo që shihet në jetën e përditshme shumë pak i jepet rëndësi mbajtjes së

bashkëshortëve ose fëmijëve, nga njëherë kjo ndodhë për shkak neglizhencës së ligjit dhe shpesh herë ndodhë nga shkak se nevojtarit nuk paraqitet në derën e duhur për ta marrë atë që i takon ligjërisht.

Prandaj ne këtu në këtë temë do të mundohemi që përafqësisht të sqarojmë mbajtjen e bashkëshortëve dhe të fëmijëve në raste të ndryshme, duke përfshirë këtu edhe legjislacione nga shtete tjera fqinje, që padyshim do të na mundësojë një pasqyrë më të pastër për të gjithë ne.

Lënda e hulumtimit

Lëndë e këtij hulumtimi është detyrimi për mbajtje ndaj bashkëshortit të pasiguruar dhe fëmijëve me vëmendje të veçantë në legjislacionin e Republikës së Maqedonisë së Veriut (RMV). Instituti i detyrimit për mbajtje dhe ushqim është një institut shumë i rëndësishëm i të drejtës familjare, por gjithashtu është i lidhur ngushtë dhe me të drejtën e detyrimeve, të drejtën trashëgimore, të drejtën përmbartëse, etj. Parimisht, ky institut është njëherazi kategori kushtetuese, që rregullohet në bazë të Kushtetutës së RMV-së, (neni 40), por dhe kategori ligjore, meqenëse si institut rregullohet në disa ligje të ndryshme, siç është Ligji për familje, Ligji për marrëdhënie të detyrimeve, Ligji për trashëgimi, etj.

Ky institut mendohet të ketë ekzistuar që nga kohërat më të vjetra dhe si praktikues të parë thuhet të kenë qenë egjiptianët, grekët dhe hebrenjtë. Fillimisht detyrimi për mbajtje është paraqitur në raste të shkurorëzimit të martesës dhe është praktikuar vetëm ndaj bashkëshortes e në raste të rralla edhe ndaj bashkëshortit por jo edhe ndaj fëmijëve.

Në Republikën e Maqedonisë së Veriut, mbajtja bazohet në parimin e solidaritetit familjar, që nënkupton se anëtarët e familjes duhet të ofrojnë mbajtje për njëri tjetrin, para se t'i drejtohen shtetit për të kërkuar ndihmë. Obligimi për mbajtje përveç që paraqet obligim kushtetues dhe ligjor, gjithashtu paraqet edhe obligim moral.

Sa i përket detyrimit për mbajtje ndaj bashkëshortit/es, korniza ligjore e RMV-së, konkretisht Ligji për familje specifikon se një ndër obligimet bashkëshortore që lindin nga martesa është *mbajtja reciproke*. Ky obligim ekziston si gjatë martesës, ashtu edhe gjatë pushimit të saj. Ligji për Familje gjithashtu përcakton rastet se kur vjen në shprehje detyrimi i

mbajtjes dhe në çdo rast është gjykata që vendos nëse njëri bashkëshort i plotëson kushtet ligjore për të fituar të drejtën e mbajtjes nga bashkëshorti tjetër.

Nga ana tjetër detyrimi për mbajtje ndaj fëmijëve paraqet një dukuri të trajtuar më gjerësisht si në nivel nacional, ashtu dhe në suaza ndërkombëtare. Kjo dukuri jo vetëm që paraqitet si kategori kushtetuese e ligjore, por paraqitet edhe si kategori Konvencionale, pasi që si e tillë trajtohet edhe në konventa të ndryshme ndërkombëtare. Sipas Ligjit për familje të Maqedonisë, prindërit kanë të drejta dhe obligime të përbashkëta që të kujdesen për personalitetin e fëmijës së tyre, të drejtat dhe interesat e fëmijëve të mitur, qofshin fëmijë martesorë, jashtëmartesorë apo të adoptuar, edhe atë deri në arritjen e moshës madhore. Në rast se fëmija ka arritur moshën madhore, mirëpo është në shkollim të rregullt apo aftësim profesional, detyrimi i mbajtjes së prindërve ndaj fëmijës vazhdohet deri në moshën 26 vjeçare.

Ligji për familje po ashtu përcakton dhe raste të tjera, kur fëmija megjithëse ka arritur moshën madhore përsëri mund të gëzojë të drejtën e mbajtjes nga prindërit e vet.

Pra, lëndë e këtij hulumtimi është detyrimi i mbajtjes që ka ekzistuar që nga kohërat më të vjetra, pra ka gjenezë të kahershme, e megjithatë duke kaluar nga etapa në etapë, nga e drejta në të drejtë si dhe nga shteti në shtet, ky institut ka pësuar disa transformime. Gjithsesi në esencë ka ngelur i njëjti, pra mbi të gjitha detyrimi për mbajtje nga njëra anë paraqet obligim të njërit bashkëshort ndaj tjetrit, apo të prindërve ndaj fëmijëve, e nga ana tjetër paraqet të drejtë të bashkëshortit të pasiguruar e fëmijëve, si përfitues të mbajtjes.

Lëndë e këtij hulumtimi më konkretisht do të jetë trajtimi i zhvillimit historik të detyrimit për mbajtje, rregullimi aktual i këtij insituti nga legjislacioni i RMV, por dhe nga legjislacione të vendeve të tjera si Shqipëria dhe Italia, dhe analizimi i disa vendimeve nga praktika gjyqësore e Gjykatës themelore civile e Shkupit lidhur me këtë detyrim.

Qëllimet e hulumtimit

Mënyra se si i qasemi hulumtimit të një dukurie, paraqet atë se çka duam të dimë në lidhje me atë dukuri si dhe çka duam të konkludojmë. Ekzistojnë mënyra e rrugë të ndryshme për t'u realizuar një hulumtim, mjafton që të jetë përcaktuar saktë qëllimi i atij hulumtimi, pasi

që një dukuri mund të hulumtohet nga ana e jashtme e saj, thelbi i saj, korniza ligjore e cila e trajton të njëjtën, të bëhet krahasimi, të vërtetohet ose të mohohet diçka e kështu me radhë.

Sa i përket temës së lartpërmendur të cilën e kam zgjedhur si punim magjistrature, unë kam për qëllim të hulumtoj se nga e ka gjenezën instituti i detyrimit për mbajtje dhe cili ka qenë zhvillimi historik për të ardhur deri në ditët tona, si është trajtuar në të kaluarën dhe si trajtohet tani, cili është rregullimi ligjor i këtij instituti në legjislacionin e RMV, por dhe në vende të rajonit e të Evropës, si Shqipëria dhe Italia, a ka mangësi apo përparësi rregullimi i këtij instituti nga legjislacioni i RMV krahasuar me legjislacionet e këtyre dy vendeve, a realizohet në praktikë detyrimi ligjor për mbajtje ndaj bashkëshortit të pasiguruar dhe fëmijëve sidomos në raste të shkurorëzimit, për të përfunduar me konkluzione dhe rekomandime të miat të cilat do të jenë rezultat i natyrshëm i punës hulumtuese të mëtejshme.

Detyrimi i mbajtjes së bashkëshortit/es dhe fëmijëve paraqet nga njëra anë një institut ligjor të një rëndësie të veçantë, që është jo vetëm dukuri kushtetuese e ligjore, por edhe dukuri konvencionale, por nga ana tjetër paraqet dhe një institut me një rëndësi të madhe sociale, që ka për qëllim kryesor sigurimin e ekzistencës së anëtarëve në nevojë të familjes.

Për këtë arsye qëllimi i këtij hulumtimi është që po e njëjta rëndësi të reflektohet tek personat në nevojë që nuk kanë njohuri të mjaftueshme për të drejtat dhe detyrimet e tyre në rastet kur ndodhen përpara situatave ku mbrojtja nuk u ofrohet vullnetarisht nga ata që e kanë detyrimin ligjor për t'i mbajtur, e sidomos në rastet e shkurorëzimit të martesës.

Hipotezat

Gjatë këtij hulumtimi shkencor do të paraqesim disa hipoteza, të cilat do të vërtetohen gjatë përpunimit të tezës. Hipotezat e punimit janë si në vijim:

- Rregullimi ligjor i institutit të mbajtjes në RMV është në nivel të kënaqshëm, krahasuar me legjislacionin e vendeve të rajonit, e megjithatë shumë shpesh realizimi në praktikë i kësaj të drejte nga bashkëshorti/ja dhe fëmijët në nevojë has në problematika të shumta, sidomos në rastet e shkurorëzimit të martesës.

- Organet shtetërore kanë një rol të rëndësishëm në zbatimin në afat të arsyeshëm e në një shumë monetare të arsyeshme të detyrimit për mbajtje ndaj bashkëshortit/es të pasiguruar dhe fëmijëve.

Metodologjia e hulumtimit

Në përgjithësi Metodologjia paraqet disiplinë shkencore që merret me përkufizimin dhe sistematizimin e metodave – mënyrave të përshtatshme të njohjes së temës së hulumtimit.

Ndërsa, metodat e hulumtimit paraqesin mënyra, mjete dhe teknika që mund të përdoren për mbledhjen e të dhënave ose për mbledhjen e provave dhe analizën e tyre.

Ekzistojnë metoda të ndryshme për të hulumtuar një dukuri, mirëpo varësisht nga dukuria, do të përdoren vetëm ato metoda që janë të nevojshme për realizimin e suksesshëm të këtij hulumtimi.

- Metoda dogmatike juridike - meqenëse në studimet e thelluara të drejtësisë asnjë punim i mirëfilltë shkencor nuk mund të përfundohet me sukses pa përdorimin e kësaj metode.
- Metoda krahasuese - na jep një pasqyrë për të krahasuar dy fenomene apo dukuri të ndryshme dhe për të nxjerrur në pah ndryshimet që ekzistojnë mes tyre. Më konkretisht, do të krahasohet legjislacioni i RMV me atë të vendeve të rajonit si Kosova dhe Shqipëria, si dhe me legjislacionin e një vendi të Unionit Evropian, si Italia, për të parë nëse legjislacioni ynë është i harmonizuar me legjislacionin e vendeve evropiane në këtë drejtim.
- Metoda historike - na tregon rrugëtimin dhe zhvillimin e këtij fenomeni që nga kohërat më të vjetra dhe mënyrën se si është trajtuar deri në ditët tona.
- Anketa dhe intervista – i referohet të dhënave që dalin si rezultat i mendimeve dhe përgjigjeve të dhëna nga një grup më i madh njerëzish apo nga përgjigjet e dhëna nga një person i caktuar të cilit në mënyrë fizike, virtuale dhe të drejtëpërdrejtë i parashtrihen pyetje. Më konkretisht do të përdoren për të parë nivelin e njohjes së këtij instituti nga qytetarët.

Rëndësia e punimit

Nëse e shikojmë kronologjikisht, që nga koha kur ka filluar të shfaqet detyrimi i mbajtjes në shoqëri e deri më sot, mund të themi se rrugëtimi i tij ka pësuar transformime të shumta. Në të kaluarën detyrimi për mbajtje nuk ka pasur formën që njohim sot, por më shumë ka qenë si lloj kompensimi i cili është paraqitur në rast të shkurorëzimit, nëpërmjet dhënies së disa mjeteve zakonisht nga ana e bashkëshortit bashkëshortes. Me kalimin e kohës dhe me zhvillimin e shtetit dhe të së drejtës ky institut fillon të pësojë shumë ndryshime pozitive. Ndër shtetet e para të cilat e kanë përfshirë këtë institut në legjislacionet e tyre, kanë qenë shtetet të cilat kanë aplikuar të drejtën kanonike. Sipas të drejtës kanonike, në rast të shkurorëzimit, burri ka qenë i obliguar që ti japë alimentacion gruas së shkurorëzuar, ndërsa vetëm në rastet kur gruaja ka qenë fajtores për shkurorëzimin, ajo ka qenë e obliguar që t'i japë alimentacion burrit.

Parë në këndvështrim historik vërejmë se instituti i mbajtjes edhe pse paraqet një institut të vjetër, nuk ka qenë i trajtuar më gjerësisht për arsye se ka rregulluar vetëm pjesën e alimentacionit mes bashkëshortëve. Në ditët tona instituti i detyrimit për mbajtje trajtohet në suaza më të gjera, sepse tani me detyrimin e mbajtjes përveç se rregullohen raportet mes bashkëshortëve, rregullohen edhe raportet prindër - fëmijë, raportet me familjarët e afërt e kështu me radhë.

Rëndësia e këtij punimi është e lidhur me rëndësinë e madhe praktike dhe sociale që ka instituti i mbajtjes, që mbi të gjitha ka për qëllim sigurimin e ekzistencës së bashkëshortit/es dhe fëmijëve që nuk kanë mjete të mjaftueshme për jetesë. Detyrimi për mbajtje bazohet në parimin e solidaritetit midis anëtarëve të familjes dhe prandaj fillimisht barra për të siguruar mjetet për jetesë të anëtarëve të familjes që për arsye të ndryshme nuk mund ta sigurojnë vetë jetesën bie mbi anëtarët e familjes, bashkëshortin/en, prindërit që mund t'ua sigurojnë atyre mbajtjen. Vetëm në mënyrë subsidiare, nëse edhe bashkëshorti/ja apo prindërit mbi të cilët rëndon detyrimi për mbajtje nuk kanë mundësi financiare t'u ofrojnë mbajtje anëtarëve të familjes, ndërhyjnë shteti nëpërmjet politikave sociale dhe dispozitave të Ligjit për mbrojtje sociale.

Rëndësia e këtij punimi qëndron dhe në atë se, nga hulumtimet që do të bëhen në lidhje me këtë temë do të arrijmë të kuptojmë se si është trajtuar ky institut në të kaluarën, si e trajtojnë vendet dhe të drejtat e ndryshme, ndryshimet që ka pësuar ky institut në rrugëtimin e tij deri më tani, të drejtat dhe detyrimet që rrjedhin për palët nga ky institut, të drejtat dhe përfitimet për palën që ndodhet në pozitë jo të volitshme, sidomos për gratë dhe fëmijët të cilët janë një kategori më e prekshme, çfarë vendimesh sjellin gjykatat në këto raste, si realizohen këto vendime dhe cilat janë vështirësitë praktike deri në marrjen e alimentacionit sidomos në rastet e shkurorëzimit. I rëndësishëm është dhe fakti se për dallim nga e kaluara kur detyrimi i mbajtjes ka ardhur në shprehje vetëm në rast të shkurorëzimit, tani sipas Ligjit për familje të RMV-së detyrimi për mbajtje midis bashkëshortëve ekziston si gjatë martesës ashtu edhe në rast të pushimit të saj, kuptohet sipas kushteve të parapara me ligj, ndërsa detyrimi për mbajtje i prindërve ndaj fëmijëve ekziston edhe pas arritjes së moshës madhore edhe atë deri në moshën 26 vjeçare nëse fëmija është në shkollim të rregullt apo në aftësim profesional.

Tjetër fakt që vlen të theksohet është edhe rëndësia dhe roli i organeve shtetërore në aplikimin dhe zbatimin e këtij instituti, pasi që shteti jo vetëm që e sanksionon këtë institut me anë të gjykatës, por me organet e tij siç është Qendra për punë sociale, u ofron ndihmë palëve në rast se pala tjetër nuk ka mundësi t'u ofrojë mbajtje palës e cila ndodhet në pozitë jo të volitshme.

1. ZHVILLIMI HISTORIK DHE KUPTIMI AKTUAL I DETYRIMIT PËR MBAJTJE

1.1. Trajtimi historik i detyrimit të mbajtjes, gjeneza e tij

Detyrimi për mbajtje është si pjesët e historisë më të gjatë kështu që nuk mundemi të themi që tash në shekullin që jetojmë kemi arrit të bëjmë një zbulim të madh por si detyrë ka qëndruar me vite, por në fakte shohim që kohë pas kohe ka pasur ngecje në implementimin e saj.

Njeriu duhet që nëse është i aftë të siguroj vetë të ardhurat e tij, pra ekzistencën e tij kurse për ata që nuk mundën ta sigurojnë një gjë të këtillë atëherë shumë e logjikshme dhe shumë e drejtë që së pari të ju drejtohet të afërmeve të familjes për ndihmë rreth plotësimit të nevojave të tij, prandaj edhe për veprime të këtilla ekziston renditje se si duhet të drejtohen për ndihmën që ju takon dhe ju garantohet me ligj, dhe një veprim i tillë është dëshmuar me kohë se cili variant është më i kapshëm, pra duke e plotësuar ligjin për detyrime dhe atë të familjes sa më shumë që të jenë në ndihmë të dy bashkëshortëve dhe vetë fëmijës.

Kështu që nëse e shohim për nga histori e saj mbajtja e familjes pra të fëmijëve dhe bashkëshortëve do të shohim se një veprim i tillë në Angli u zhvillua si pjesë e divorcit që në gjykatën kishtare pra ajo fetare dhe e cila më vonë u përcjellë edhe në sistemin demokratik të tyre. prandaj edhe Chester G. Vernier dhe John B. Hurlbut në çështjen e historisë së detyrimit të mbajtjes shkruan: “Përpara vitit 1857, gjykatat kishtare që aplikonin kryesisht të drejtën kanonike, ushtronin juridiksion për shkaqet martesore dhe për rrjedhojë edhe dhënien e ushqimit. Martesa mendohej të ishte një sakrament dhe e pazgjidhshme. Divorci a mensa et thoro u dha për tradhti bashkëshortore dhe mizori.”¹

Pra sikur që shihet praktikimi i alimentacionit është që herët në botë perëndimore edhe kohën kishtare mundoheshë kjo të veprohej që të arrinin deri te pajtimi i bashkëshortëve , pra ishte si një rrugë për deri te pajtimi, prandaj edhe ky veprim i aristokracisë ishte që i pri aktit të

¹ Chester V. Gernier and John B. Hurlbut, THE HISTORICAL BACKGROUND OF ALIMONY LAW AND ITS PRESENT STATUTORY STRUCTURE , f. 197.

divorcit të vitit 1857 e cila do të përdorej prej gjithave shteteve Amerikane, dhe po ashtu të njëjtën e gjemë edhe te shtete Evropiane.

I gjithë ky veprim që u morë ishte si pikëpamje financiare për të i siguruar gruas në veçanti një formë të jetesës, ngase pabarazia ishte e madhe dhe gruaja apo gjinia femërore ishte shumë e anashkaluar dhe në raste të divorceve për tu mbrojtur interesi edhe i i gruas u parashikua detyrimi i mbajtjes me ushqim, edhe për këtë Chester G. Vernier dhe John B. Hurlbut shkruan: "Objekti kryesor i urdhrit për ushqim të përhershëm ishte siguri i mbajtjes së vazhdueshme për gruan."²

Pra mbajtja e detyrimeve ka për qëllim të sigurojë mbështetje financiare për bashkëshortin që fiton më pak të ardhura, ose në disa raste nuk ka fare të ardhura. Për shembull, në rastet kur ka fëmijë të përfshirë, burri ka qenë historikisht mbajtësi i familjes dhe gruaja mund të ketë hequr dorë nga karriera e saj për të rritur fëmijët dhe do të jetë në disavantazh financiar pas ndarjes ose divorcit. Ligjet në shumë shtete urdhërojnë që një bashkëshort i divorcuar të ketë të drejtën të jetojë të njëjtën cilësi të jetës që kishte më parë kur ishte i martuar.

Nëse shohim historinë mund të themi se detyrimi për mbajtje përfshinte më shumë se një matje të thjeshtë gjyqësore të detyrës ligjore të burrit si bashkëshort për të mbështetur gruan. Kështu që edhe gjatë rrjedhës kohore kemi hasur problematike kur bashkëshorti nuk është kujdesur aspak për bashkëshorten nën kujdesin ose detyrimeve të mbajtjes, por edhe tjetra kur bashkëshortja nuk është kujdesur për fëmijët dhe bashkëshortin dhe në bazë të kësaj është pa që është më se e domosdoshme nxjerrja e një ligji dhe plotësimi i saj me çka do jenë në interes të dy palëve dhe fëmijëve, si dhe do të plotësohet e drejta njerëzore.

Pra nëse shohim në fillim detyra e mbajtjes ka qenë për fëmijët vetëm, më pas është parë që edhe vetë bashkëshortët kanë nevojë për ndihmën e njëri tjetrit dhe kështu është plotësuar njëra pjesë, më vonë parashihet edhe detyra e mbajtjes e fëmijëve drejt prindërve deri sa ata nuk kanë mundësi që prindërit të mbajnë njëri - tjetrin.

Veprimet e këtilla për mbajtje e detyrueshme të bashkëshortëve është veprim që veprohet tani gjithkund në botë, por ka edhe vende të cilët kanë paraparë kushte për plotësimin e detyrimit të mbajtjes sikurse që është: "Çdo juridiksion amerikan përveç Karolinës së Jugut ka

² Chester V. Gernier and John B. Hurlbut, THE HISTORICAL BACKGROUND OF ALIMONY LAW AND ITS PRESENT STATUTORY STRUCTURE, f. 199

një statut që rregullon lejimin e alimentacionit për gruan në divorc absolut. Në dy shtete (Delaware, Teksas") kompensimi është indirekt dhe në formën e një ndarjeje të pronës. Në një tjetër (Karolina e Veriut") statuti autorizon gjithashtu një ndarje të pronës, por është fragmentare dhe e paqartë. Në juridiksionet e mbetura do të merren parasysh pikat e mëposhtme:

1. Nëse ushqimi i përhershëm duhet të jepet para ose pas dekretit përfundimtar, ose vetëm në një dekret të tillë;
2. Nëse vendimi është nga gjykata ose juria;
3. Emrin ose përshkrimin ligjor të çmimit;
4. Kushtet e dhënies, si fajësia e burrit, nevoja e gruas etj ”³

Pra mund të themi se historia dëshmon dhe ka dëshmuar që çështja e mbajtjes është kohë e gjatë që ka filluar të implementohet edhe pse në forma të ndryshme, kohë pas kohe ka pësuar ndryshme të cilat pa dyshim kanë qenë në të mirën e vetë njerëzimit duke e plotësuar të drejtën që atij i takon.

1.2. Trajtimi historik i detyrimit të mbajtjes sipas legjislacionit të ish Jugosllavisë

Sistemi i Jugosllavisë dhe shteti i saj edhe pse të formuar si të më vonshëm por në aspektin juridik të saj është munduar që të përfshij edhe të drejta e martesës, ku si pjesë e këtij kapitulli ka qenë edhe detyrimi për mbajtje , por për dallim prej ligjvënësit të ditëve moderne edhe ligjvënësi në kohën e shtetit Jugosllavë është munduar që në skaje të sistemit komunist që kishte brenda vetës të ruaj dinjitetin dhe drejtësinë në mes njerëzve.

Kështu në neni 67 thuhej:

”Bashkëshorti i pasiguruar që është i paaftë për punë ose është i papunë dhe që nuk është fajtor për shkurorëzimin, ka të drejtë që të kërkojë që vendimit për shkurorëzim të martesës t’i jepet një shumë e caktuar në emër të mbajtjes së barrës së bashkëshortit tjetër, në përpjesëtim me aftësinë e tij.”⁴

³ Chester V. Gernier and John B. Hurlbut, THE HISTORICAL BACKGROUND OF ALIMONY LAW AND ITS PRESENT STATUTORY STRUCTURE , f. 201 - 202

⁴ Ligji themelor për martesë, neni 67, Gazeta Zyrtare e RSFJ - së, nr. 304 i datës 23.04.1965

Sipas këtij neni shihet që për detyrimit të mbajtjes duhen të plotësohen kushte që i ka para parë ligjvënësi që në kohën Jugosllave, këto kushte janë:

1. Paaftësia për punë,
2. Papunësia,
3. Të mos jetë fajtor në rastin e shkurorëzimit.

Nëse plotësohen këto kushte atëherë bashkëshorti i cili shkurorëzohet apo ka kërkuar që të bëjë divorc nuk është fajtor i fatkeqësisë së shkurorëzimit ka të drejtë, apo ka lejuar ligjvënësi i atëhershëm që të kërkojë mbajtjen e tij apo kujdesen e tij dhe fëmijës, duke i dhënë në këtë rast bashkëshortit es një shumë të caktuar që do i ndihmojë deri në gjetjen e një zgjidhje për të.

Nga ana tjetër ligji për martesë i Jugosllavisë ka parashikuar edhe rastin kur duhet që të i ndërpritet apo kohën kur mbaron mbajtja, kështu në paragrafin e dytë të nenit 67 thuhet:

”E drejta e mbajtjes pushon nëse bashkëshorti i shkurorëzuar që gëzon alimentacion lidh një martesë të re, ose nëse gjykata duke i shqyrtuar rrethanat, konstaton se bashkëshorti i shkurorëzuar është i padenjët për të.”⁵

Sikur që shihet nga pika e dytë e këtij neni që detyrimi për mbajtje nuk vazhdon përgjithmonë, por ajo ka renditje se kur i takon dhe kur i ndalohet, kështu që mbajtja i ndërpritet kur:

1. Nëse lidh martesë të re,
2. Shkaku i rrethanave të ndryshëm.

Nëse lidhet martesë e re ndërpritet mbajtja për shkak se vetëm në fuqi hyjnë detyra dhe obligime të tjera në mes bashkëshortëve të ri, kurse rrethanat e ndryshme të cilat gjyqi i parasheh si të arsyeshme munden me qenë të ndryshme sikurse që është dhe ka qenë:

1. Mundësia për të punuar, por mos interesimi për të punuar.
2. Aftësia për të punuar ka qenë prezentë, po mos dëshira për punë ka qenë shkak.
3. Kur mbas divorcit dhe dhënies së mbajtjes njërit bashkëshort ndaj tjetrit, është vërtetuar që bashkëshorti i cili gëzon mbajtjen në fakt është vetë fajtor i shkurorëzimit.

Në këto raste bashkëshorti i cili gëzon mbajtjen i ndërpritet në formë direkt alimentacioni dhe duhet që të mbaj vetveten bashkëshorti në fjalë vetë.

⁵ Ligji themelor për martesë, neni 67, Gazeta Zyrtare e RSFJ - së, nr. 304 i datës 23.04.1965

Sistemi i shteti RSFJ - së e ka vendosur çështjen e mbajtjes në këtë nen, për shkak se shkurorëzimet në atë kohë nuk kanë qenë në numër aq të madh sikurse që janë tani, prandaj edhe ka mjaftuar ndoshta një nen i përbërë nga dy paragrafë për të mbledhur ajo që i takon mbajtjes së bashkëshortëve në raste të shkurorëzimit.

Por kjo nuk e bënë që sistemi Jugosllavë edhe pse në pamje të parë duket shumë i përsosur për kohën e vetë, kjo nuk ka vlejtur edhe në mesin e popullatës, ngase çdoherë njeriu mundohet që të gjejë një formë për të i ikur përgjegjësisë që i takon, prandaj edhe thuhet: "Avokatët kroatë thonë se historia e divorcit fiktive dhe alimentacionit nuk është asgjë e re. Kjo dukuri ishte mjaft e përhapur edhe në ish-Jugosllavi kur kishte të drejtat e qirasë,"⁶ asgjë nuk është bardh e zi sikurse që shfaqet.

1.3. Kuptimi dhe karakteristikat e mbajtjes sipas Ligjit për familje te RMV-së

Maqedonia si shtet i pavarur është që nga vitit 1991 i shpallur zyrtarisht, dhe si i tillë në aspektin civil sikur ka pasur ngecje në këtë drejtim, edhe pse kohë pas kohe është munduar që të krijoj sisteme ligjvënësi me çka do të mbrohen të drejtat e palëve, por nuk mundemi të themi se një hap i këtillë ka qenë i përsosur, por janë orvatur që të shkojnë drejt përsosmërisë.

Sa i përket mbajtjes së bashkëshortëve dhe fëmijëve nuk mundemi të themi se një veprim i tillë është i siguruar vetëm se me ligjin për familje apo të detyrimeve, por në fakt ajo është e parashikuar edhe në vetë Kushtetutën e Republikës së Maqedonisë së Veriut në neni 40 ku thuhet:

"Republika ofron kujdes dhe mbrojtje të veçantë për familjen. Marrëdhëniet juridike në martesë, në familje dhe në bashkëjetesë rregullohen me ligj. Prindërit kanë të drejtë dhe detyrë të kujdesen për mirëmbajtjen dhe edukimin e fëmijëve të tyre. Fëmijët janë të detyruar të kujdesen për prindërit e tyre të moshuar dhe të dobët. Republika ofron mbrojtje të veçantë për jetimët dhe fëmijët pa përkujdesje prindërore."⁷

⁶ <https://netpress.com.mk/hrvatite-se-razveduvaat-za-da-ne-plakjaat-kredit/> e marur me datë 15.04.2023

⁷ Kushtetuta e Republikës së Maqedonisë së Veriut, 1991, neni 40

Kushtetuta ka përcaktuar që prindërit kanë të drejtën e tyre juridike për të plotësuar detyrat e kujdesej ndaj njëri tjetrit dhe vetë fëmijëve, dhe të cilat janë të mbrojtura me këtë kushtetutë.

Kurse sa i përket ligjit për familje si nisje për mbrojtjen e familjes përcaktimin e detyrave dhe obligimet, në neni 11 ka përkufizuar edhe çështjen e mbajtjes ku thuhet:

”Mbajtja është e drejtë dhe detyrë e prindërve, fëmijëve dhe të afërmeve të tjerë të përcaktuar me këtë ligj si edhe e personave që jetojnë në bashkësi martesore ose jashtëmartesore.”⁸

Kështu që mbajtja është detyrë e përgjithshme i cili bien mbi prindërit, fëmijët dhe të afërmit duke mos e marr parasysh se a jetojnë në bashkësi martesore ose jashtë saj.

Pra mbajtja shihet si e drejt dhe detyrim, por nuk mund të themi se ka një definicion më të saktë rreth saj edhe pse sipas praktikës gjyqësore, alimentacioni apo mbajtja paraqet sigurimin e mjeteve të nevojshme materiale për personat që kanë të drejtë, për pagesën e të gjitha shpenzimeve të nevojshme për ushqimin, veshjen, mjekimin e tyre, dhe nëse bëhet fjalë edhe për fëmijën atëherë merren parasysh edhe shpenzimet e shkollimit dhe edukimit të tyre.

Mund të themi se mbajtja ka karakter pasuror me të cilën obligohen bashkëshortët në mes vete dhe fëmijët, prandaj edhe në neni 278 thuhet: ”Mbajtja financiare në kuptimin e këtij ligji nënkupton detyrimin financiar dhe material”⁹

Ligjvënësi brenda shtetit tonë çdoherë mundohet që të jetë në hap me kohë edhe pse nëse e shohim realitetin ligji për familje nuk ka pësuar ndryshme të mëdha që nga vitit 2001, po edhe pse ligji për marrëdhënie detyrimeve është si pjesë ndihmëse e saj, shpesh shohim se hasin në problematika të reja që nuk janë përfshijë në ligjvënien.

Pra marrëdhëniet që lindin me rastin e mbajtjes nuk janë si marrëdhëniet e tjera të detyrimeve, para se gjithash për shkak të qëllimit që kërkon të arrij, për këtë arsye ligjvënësi ka formuluar norma imperative të cilat zbatohen, për realizimin e qëllimit që rrjedh nga detyrimi i mbajtjes.

⁸ Ligji për familje, neni 11, Gazeta zyrtare e RMV. nr. 80/92, 9/96, 38/04, 33/06, 84/08, 67/10, 156/10, 39/12, 44/12, 38/14, 115/14, 104/15,

⁹ Po aty, neni 278,

Karakterit personal i të drejtave dhe detyrimeve që rrjedh nga mbajtja është një nga karakteristikat kryesore, në këtë rast bashkëshorti dhe bashkëshortja apo ndryshe që mund ti quajm debitori dhe kreditori nuk janë njerëz që rastësisht takohen, por ata kanë qenë në këtë bashkësi në rrethana të ndryshme, pra nuk ka qenë qëllimi pasuror që nga fillimi i saj, por me kohe dhe në rrethana kanë arritur deri në këtë pikë.

Si karakteristik tjetër e mbajtjes është se me vdekjen e njërit prej palëve qon në shuarjen e detyrimeve, dhe ato nuk kalojnë te trashëgimtari.

Pra këto janë karakteristika të mbajtjes të cilat janë prezentë në shumicën e rasteve këtu në shtetin tonë, ndërsa kemi edhe karakteristika të tjera të cilat i hasim brenda rasteve të ndryshme të mbajtjeve.

1.4. Parimet themelore të mbajtjes financiare

Parimet themelore të mbajtjes financiare janë pjesë përbërëse të mbajtjes, pa të cilat nuk mundet të realizohet, dhe janë pjesë përbërëse e alimentacionit apo mbajtjes. Ligjvënësi në Republikën e Maqedonisë së Veriut edhe për këtë ka paraparë në ligjin për familje ku thuhet:

1. "Mbajtja financiare në kuptimin e këtij ligji nënkupton detyrimin financiar dhe material
2. Të afërmit në vijë të drejtë janë të detyruar të sigurojnë mbajtje financiare reciproke"¹⁰

Duke e pasur parasysh këtë themi se parimet për mbajtjen financiare është aspekti financiar dhe material për të cilën ka nevojë pala tjetër, me çka i sigurohet forma e jetesës deri në një afat të caktuar, më saktë deri sa të mundësohet të siguroj vetën e tij. Kurse nga ana tjetër po ashtu për përmbushjen e këtij parimi është përcaktuar renditja se kush ka për detyrë përmbushjen e këtyre detyrimeve, prandaj edhe në pikën e dytë thuhej që të afërmit në vijë të drejtë obligohen përmbushjen e atyre obligimeve sikurse që janë:

- Bashkëshortët njëri - tjetrin.
- Prindërit fëmijët e tyre.
- Fëmijët prindërit dhe të tjerë.

¹⁰ Ligji për familje, neni 278, Gazeta zyrtare e RMV. nr. 80/92, 9/96, 38/04, 33/06, 84/08, 67/10, 156/10, 39/12, 44/12, 38/14, 115/14, 104/15,

Ndër parimet e tjera janë edhe:

1. “Është detyrim rreptësishtë personal si nga ana e personit që duhet të sigurojë ushqim ashtu edhe nga ana e personit të mbështetur dhe nuk mund të trashëgohet.
2. Heqja dorë nga e drejta e ushqimit nuk ka efekt juridik
3. E drejta e mbajtjes, e përcaktuar me ligj, nuk mbaron, por arkëtimi i kësteve individuale mund të skadojë brenda tre vjetësh, megjithatë, derisa të zgjasë e drejta prindërore, parashkrimi nuk kalon, ashtu siç nuk kalon. drejtohen ndërmjet bashkëshortëve dhe ndërmjet bashkëjetuesve derisa zgjat lidhja jashtëmartesore. komuniteti
4. Nuk ka detyrim për kthimin e mbajtjes së paguar në rast se personi në ngarkim fiton pasuri
5. Në një mosmarrëveshje gjyqësore, ushqimi jepet për të ardhmen dhe ushqimi i dhënë mund të ndryshohet.
6. Mirëmbajtja gëzon përparësi gjatë mbledhjes në procedurën e ekzekutimit të detyruar sipas ZI.
7. Mbajtja nuk mund të kompensohet me borxhet e personit në ngarkim.”¹¹

Këto janë prej parimeve kryesore që duhen ta përmbushin njëri tjetrin ato, kurse po ashtu prej parimeve mund të themi që është se personit që i takon marrja e mbajtjes nuk mund të tërhiqet prej kësaj të drejte, ne nene 178 thuhet: “Heqja dorë nga e drejta e mbajtjes nuk prodhon efekt juridik”¹²

Edhe nëse personi në fjalë shpreh dëshirën për tu tërhequr nga alimentacioni, një gjë e tillë nuk është e paraparë nga ana e ligjvënësit, pra duhet me patjetër të pranohet. Nëse këto parime janë plotësuar atëherë mund të themi se kemi të bëjmë me alimentacion, apo përkujdesje për plotësimin dhe përmbushjen e detyrimeve të mbajtjes.

1.5. Veçoritë e detyrimit për mbajtje

¹¹ <https://www.pravdiko.mk/karakteristiki-na-izdrshkata-vo-makedonskoto-zakonodavstvo/> e marr me datë 01.05.2023

¹² Ligji për familje, neni 178 pika 3, Gazeta zyrtare e RMV. nr. 80/92, 9/96, 38/04, 33/06, 84/08, 67/10, 156/10, 39/12, 44/12, 38/14, 115/14, 104/15,

Sa i përket veçorit për përmbushjen e detyrimeve të mbajtjes mund të themi që për të qenë të plotfuqishme, detyrimet duhet të jenë: të mundshme, të caktuara, të lejueshme.

Duke u nisur nga ky parim veçorit e mbajtjes duhen të jenë të këtij lloji ashtu sikurse që thuhet në nenin 279: "Vetëm personat të cilët financiarisht nuk mundën ta mbajnë vetën janë të pranueshme për mbajtje financiare"¹³

Pra personat të cilët kanë arritur deri në shkurorëzimin e tyre dhe kërkojnë të drejtën e tyre për mbajtje atëherë, kërkuesi në këtë rast duhet të ketë vetin e mos pasjes mundësi për tu siguruar vetën dhe këtyre ju mundësohet të u plotësohet kërkesa nga pala tjetër, ngase kjo është edhe e lejuar edhe e caktuar nga vetë ligjvënësi në shtetin tonë.

Po ashtu edhe në neni 280 thuhet:

"Personat të cilët duke marrë parasysh të gjitha detyrimet personale nuk janë në gjendje të sigurojnë mbajtje financiare pa rrezikuar mjetet e tyre financiare të arsyeshme nuk janë të detyruar të sigurojnë mbajtje financiare."¹⁴

Mund të themi se veçoria e detyrimit është pikë së pari të ketë :

1. Mundësia ekonomike,
2. Aftësia psikike,
3. Detyrimi ligjor,
4. Marrja e patjetërsueshme e mbajtjes.

¹³ Ligji për familje, neni 279 pika 3, Gazeta zyrtare e RMV. nr. 80/92, 9/96, 38/04, 33/06, 84/08, 67/10, 156/10, 39/12, 44/12, 38/14, 115/14, 104/15,

¹⁴ Po aty, neni 280 pika 1,

2. DETYRIMI PËR MBAJTJE NDAJ BASHKËSHORTIT DHE FËMIJËVE SIPAS LEGJISLACIONIT TË REPUBLIKËS SË MAQEDONISË SË VERIUT

2.1. Mbajtja e bashkëshortit

Bashkëshortët arrijnë që nëpërmjet martesës të futën në bashkësi familjare dhe të kenë një jetë të lumtur deri në një afat të caktuar kur njëri prej bashkëshortëve bën një veprim të pahijshëm sikurse që është tradhtia ose veprime të tjera të cilat për bashkëshortin janë të pa pranueshme, ose kur në momente të caktuara humbet dëshira për jetesë të përbashkët ose shuhet dashuria. Në këto raste ligjvënësi ka paraparë që zgjidhja të jetë nëpërmjet shkurorëzimit.

Nuk do të thotë që gjithçka mbaron me shkurorëzim por nga aty kemi një numër të madh dispozitash që dalin që duhet të plotësohen nga prindërit dhe bashkëshortët në mes tyre, sikurse që janë: mbiemri, trashëgimia, ndarja e pasurisë së përbashkët, mbikëqyrja e fëmijëve dhe mbajtja e tyre si dhe ndër detyrat që paraqiten në shesh është edhe mbajtja e bashkëshortit për një afat kohor të caktuar shkaku i rrethanave në të cilën gjenden.

Në neni 185 thuhet:

“ Bashkëshorti i cili nuk ka mjete të mjaftueshme për ushqim dhe është i paaftë për punë ose është i papunë pa fajin e vet, ka të drejtë në ushqim nga ana e bashkëshortit të vet në proporcion me mundësitë e tij.”¹⁵

Ligjvënësi në Republikën e Maqedonisë së Veriut ka paraparë që në rast të divorcit dhe njëri prej bashkëshortëve është i pasiguruar mjaftueshëm, pra mjetet e tija nuk i mjaftojnë për jetesën e tij atëherë bashkëshorti tjetër i cili është i aftë për punë dhe ka mjete financiare të mjaftueshme të mbaj bashkëshortin tjetër deri në një periudhë kohore të paraparë sipas ligjvënësit.

Nuk themi se mbajtja e bashkëshortëve është e pa kushtëzuar, por ajo kishte kushtet sikurse që ishin edhe të përmendura nga ana e ligjvënësit, sikurse që ishte:

¹⁵ Ligji për familje, neni 185 pika 1, Gazeta zyrtare e RMV. nr. 80/92, 9/96, 38/04, 33/06, 84/08, 67/10, 156/10, 39/12, 44/12, 38/14, 115/14, 104/15,

- Të mos jetë i siguruar materialisht.
- Të jetë i pa punë pa fajin e tij.

Në janë plotësuar këto dy kushte atëherë bashkëshorti tjetër ka për obligim ta mbaj palën e tjetër komfort dispozitave ligjore që i përcaktohen në këtë rast. Nuk duhet harruar se mbajtja e bashkëshortëve është pjesë e të drejtave dhe detyrimeve edhe në brendësin martesore, por edhe jashtë saj kur ekziston pamundësia sikurse edhe cekëm më lartë se nuk ka të ardhura nga aktivitete të ndryshme, nuk ka marrëdhënie pune, nuk ka pension etj, atëherë bashkëshorti tjetër obligohet me mbajtjen e tij në ushqim, veshje, banim, mjekim dhe gjëra të tjera që konsiderohen primare.

Sa i përket pa aftësisë për punë ajo mund me qenë prej ndonjë sëmundje të përhershme, e mangësive fizike, pleqëria ose invaliditeti etj. nëse ka ndonjërin prej këtyre vetive pa marr parasysh a është pa aftësia e përhershme apo e përkohshme , e plot apo e pjesshme ndaj këtij bashkëshorti duhet të plotësohen detyrimet e mbajtjes. Pra, alimentacioni ka disa karakteristika të rëndësishme të cilat mund t'i përmbledhim si më poshtë:

1. Alimentacioni midis bashkëshortëve është detyrim ligjor i ndërsjellë (neni 11, 178 LF) që rrjedh nga lidhjet familjare që lindin në bazë të martesës, ose bashkëjetesës që ka zgjatur mbi një vit. Ai lind sipas ligjit, në momentin e themelimit të këtyre marrëdhënieve.
2. Detyrimi për alimentacion realizohet pa kompensim.
3. E drejta dhe detyrimi për alimentacion është personal (intuitu personae) dhe i pabartshëm si nga ana e personit që e jep, ashtu dhe nga ana e personit që e merr alimentacionin dhe nuk mund të trashëgohet (sipas Ligjit për trashëgimi).
4. Heqja dorë nga e drejta për alimentacion nuk ka efekt juridik (neni 178/3 LF).
5. Mjetet monetare të paguara për alimentacion nuk kthehen, për arsye se alimentacioni bazohet në parimin e solidaritetit. Pra, nuk lind detyrimi që alimentacioni i paguar të kthehet në rast se personi që ka marrë alimentacion fiton të ardhura.
6. Si rregull alimentacioni jepet vetëm për të ardhmen (nemo pro praeterito allitur) sipas nenit 312/2 të Ligjit për procedurë kontestimore, ndërsa sipas praktikës gjyqësore, jepet nga dita kur ka filluar procesi gjyqësor.

7. E drejta e alimentacionit ligjor nuk parashkruhet (neni 362/3 LMD), por mund të parashkruhet në afat tre vjeçar pagesa e kësteve të veçanta të arritura (neni 361 LMD), megjithatë parashkrimi nuk rrjedh midis bashkëshortëve martesorë ose jashtë martesorë, derisa zgjat lidhja martesore ose jashtëmartesore (neni 370 pika 1,3, 4 LMD). Kjo do të thotë se personi që ka të drejtë alimentacioni mund ta realizojë këtë të drejtë në çdo kohë, përderisa janë përmbushur kushtet për alimentacion.
8. Lartësia e alimentacionit të vendosur më parë mund të ndryshojë, nëse kanë ndryshuar rrethanat në bazë të të cilave është marrë vendimi i mëparshëm (neni 201 LF).
9. Alimentacioni nuk mund të përfshihet në ekzekutimin e detyruar, ndërsa ka përparësi në pagesë gjatë procedurës së përmbarimit sipas Ligjit për përmbarim.
10. Alimentacioni nuk mund të kompensohet me detyrimet e personit që merr alimentacion (neni 330/5 LMD). Pra, nëse debitori i detyrimit për alimentacion bëhet kreditor i kreditorit të vet sipas ndonjë baze tjetër juridike, nuk mund të ketë zbritje të detyrimit.

2.2. Kërkesa për mbajtje

Sa i përket kërkesës për mbajtje është pjesë e shkurorëzimit e cila duhet të përmbushte në afate të caktuara sikurse që është:

1. Deri në përfundimin e shqyrtimit kryesor në procedurën për shkurorëzim
2. Një vit pas përfundimit të martesës.

Nga jeta e përditshme si më e zakonshme është detyrimet për mbajtje nga njëri bashkëshort bëhet gjatë procedurës së shkurorëzimit, për arsye se edhe gjyqi i ka faktet para tij për të vendos me drejtësi për kërkesën e bërë. Dhe për këtë në neni 186 thuhet:

1. "Nën kushtet e nenit 186 të këtij ligji bashkëshorti i pa siguruar ka të drejtë të kërkojë që me anë të aktgjykimit me të cilin shkurorëzohet martesa të gjykohet një shumë e caktuar në emër të ushqimit në barrë të bashkëshortit tjetër në proporcion me mundësit e tij.
2. Me përjashtim nga dispozita e paragrafit 1 të këtij ligji, bashkëshorti ka mundësi që me anë të padisë së veçantë, me afat prej një viti pas pushimit të martesës të kërkojë

ushqim, vetëm nëse kushtet për ushqim të përcaktuar me neni 185 të këtij ligji kanë ekzistuar që në momentin e përmbylljes së seancës kryesore të procedurës për shkurorëzim të martesës dhe pandërprerë kanë vazhduar deri në përmbylljen e seancës kryesore në procedurën për ushqim.”¹⁶

Pra nëse nevoja për mbajtje është paraqitur pas mbarimit të seancës kryesore, edhe pse paditësi në këtë rast nuk ka të drejtë që të kërkojë detyrimin e mbajtjes dhe e bënë një gjë të tillë, atëherë Gjykatësi është i detyruar që në formë ligjore ti përgjigjet që duke i pasur për bazë faktet që gjatë shkurorëzimit nuk ka qenë kushtet të paraqitura për plotësimin e detyrimit të mbajtjes, një kërkesë e tillë refuzohet.

Po ashtu kjo kërkesë refuzohet edhe kur bashkëshorti është sjellë me palën tjetër në mënyrë jo etike pa asnjë shkak, për këtë në neni 187 thuhet: “Gjykata mund ta refuzojë kërkesën për ushqim nëse këtë e kërkon bashkëshorti i cili pa shkak serioz është sjellë në mënyrë të vrazhdë dhe të padrejtë në bashkësinë martesore ose kërkesa e tij do të paraqiste padrejtësi evidente për bashkëshortin tjetër.”¹⁷

Në raste kur kërkesa është bërë mbas një vitit edhe në këtë rast gjykatësi ka të drejtë ta refuzojë kërkesën nëse shihen fakte që bashkëshortët kanë mundur ta sigurojnë jetesën e tij, ne neni 189 thuhet: “Gjykata mund që ta refuzojë kërkesën për ushqim nëse bashkëshortët në një periudhë më të gjatë sa kanë jetuar të ndarë, plotësisht në mënyrë të pavarur kanë siguruar mjetet për ushqim, ose nga rrethanat e rastit vërtetohen se bashkëshorti që kërkon ushqim nuk është sjellë në gjendje më të vështirë materiale se sa që ka qenë para lidhjes së martesës.”¹⁸

Por në raste kur edhe pas një vitit pas shkurorëzimit të martesës paraqitet kërkesë për plotësimin e detyrimit të mbajtjes dhe gjykatësi duke marr për bazë se kushtet kanë qenë të plotësuar që gjatë kohës së seancave të shkurorëzimit, atëherë një kërkesë të këtillë e aprovon.

2.3. Përcaktimi i mbajtjes

¹⁶ Ligji për familje, neni 186, Gazeta zyrtare e RMV. nr. 80/92, 9/96, 38/04, 33/06, 84/08, 67/10, 156/10, 39/12, 44/12, 38/14, 115/14, 104/15,

¹⁷ Po aty, neni 187,

¹⁸ Po aty, neni 189,

Sa i përket përcaktimit të mbajtjes për këtë në neni 194 thuhet: "Gjatë përcaktimit të nevojës për ushqim të personit, gjykata do të merr parasysh gjendjen e tij pronësore, aftësinë për punë, mundësin për punësim, gjendjen shëndetësore, si dhe rrethanat e tjera nga të cilat varet vlerësimi mbi nevojat e tij."¹⁹

Nga ky nen mund të thuhet se personi apo bashkëshorti i cili kërkon që ti mundësohet të merr mbajtje, ndaj këtij bashkëshorti gjyqi ka parasysh arsyet dhe kushtet që i duhen për të përcaktuar se kërkuesi a duhet ti aprovohet kërkesa e tij apo të i refuzohet. Nëse bashkëshorti ka në pronësinë e tij shtëpia, vetura, pasuri të paluhatshme, ose është aksionar në ndonjë firmë qoftë edhe me përqindje shumë të vogël, në këtë rast gjykatësi përcaktohet se kërkuesi nuk ka nevojë për të kërkuar mbajtje, gjithashtu gjyqi merr parasysh edhe mundësin dhe aftësinë për të punuar dhe nëse problemi i punës qëndron në atë se nuk është preciz në punën e tij, është joprofesional etj, d.m.th. mundësia e punës ekzistojnë por për shkaqe individuale dhe profesionale i refuzohet puna atëherë kërkesa e tij refuzohen dhe nëse në të kundërtën vërtetohet pa mundësi për të punuar atëherë i miratohet kërkesa.

Po ashtu prej kushteve të përcaktimit të mbajtjes është edhe gjendja shëndetësore e cila i lejon që kërkuesi në këtë rast ti takon mbajtja, qoftë se ka ndonjë sëmundje psikike apo fizike qoftë e përkohshme apo e përhershme.

Përpos kësaj gjyqi në raste të këtilla merr parasysh edhe bashkëshortin tjetër nga i cili kërkohet përmbushja e detyrimeve për mbajtje sikurse që thuhet në neni 194 pika e 3: "Gjatë vërtetimit të mundësive të personit i cili është i obliguar që të jepe ushqim gjykata do t'i marrë parasysh të gjitha të ardhurat e tij, nevojat e tij personale dhe obligimet e tija ligjore në ushqim të personave të tjerë."²⁰

Ashtu sikurse që merren parasysh kushtet e bashkëshortit që kërkon mbajtje, po ashtu gjykatësi shqyrton edhe kushtet e bashkëshortit i cili duhet ta përmbushë këtë detyrë sikurse që është, mundësia ekonomike, mos dëmtimi i tij gjatë plotësimit të obligimit, mundësia e sasisë së caktuar për mbajtje et.

¹⁹ Ligji për familje, neni 194, pika 1, Gazeta zyrtare e RMV. nr. 80/92, 9/96, 38/04, 33/06, 84/08, 67/10, 156/10, 39/12, 44/12, 38/14, 115/14, 104/15,

²⁰ Po aty, neni 194, pika 3,

2.4. Kohëzgjatja e mbajtjes

Koha e mbajtjes është e ndryshueshme në varësi prej ligjvënësit dhe bashkëshortëve gjegjësisht të kushteve të tyre, sipas dispozitave ligjore, e drejta e mbajtjes të bashkëshortëve zgjat më së shumti 5 vjet nga përfundimi i bashkësisë martesore, por me kërkesë të bashkëshortëve kjo mund të vazhdohet edhe pas atyre 5 viteve nëse vërtetohen që ekzistojnë kushtet që e bëjnë bashkëshortin tjetër të pa aftë edhe më tej për ta siguruar vetën

Në neni 189 thuhet:

1. “E drejta në ushqim të bashkëshortit të mëparshëm të pa mbajtur, zgjatë më së shumti 5 vjet pas shkurorezimit apo anulimit të martesës.
2. Me kërkesë të bashkëshortit, gjykata mund të vazhdoj të drejtën për ushqim edhe pas kalimit të afatit të paraparë me paragrafin 1 të këtij neni, nëse vërtetohet se për këtë ekzistojnë shkaqe të ndryshme, e veçanërisht nëse bashkëshorti i pa mbajtur edhe pas kalimit të këtij afati nuk do jetë në gjendje të sigurojë ushqim.”²¹

Në këtë nen nuk janë paraparë shkaqet dhe rrethanat për vazhdimin e mbajtjes, por mendohet se vazhdim i mbajtjes mund të jenë nëse bashkëshorti është i sëmurë ose i pa aftë për të siguruar ekzistencën e tij. Një ndër kushtet e vazhdimit të mbajtjes është edhe që padia duhet të bëhet para se të kalohet limiti 5 vjeçar dhe më pas të vendoset a mund të vazhdohet apo ndërpritet me aq detyrimi i mbajtjes.

Por nga ana tjetër duhet të kemi parasysh se formë të prerë e vendosur që çdo kujt që i takon mbajtja e ka të siguruar për 5 vite, por jo, ajo mundet të jetë edhe më pak se 5 vite nëse gjykatësi në këtë rast e sheh si të arsyeshme përcaktimin e kohës në afat më të shkurt, edhe në neni 190 thuhet:

1. “Gjykata mund të përcaktojë që obligimi për ushqim të zgjasë edhe më pak se 5 vite kur ekziston supozimi se kërkuesi i ushqimit ka mundësi që në kohë të caktuar në ndonjë mënyrë tjetër të sigurojë mjete për ushqim”²²

²¹ Ligji për familje, neni 189, Gazeta zyrtare e RMV. nr. 80/92, 9/96, 38/04, 33/06, 84/08, 67/10, 156/10, 39/12, 44/12, 38/14, 115/14, 104/15,

²² Ligji për familje, neni 190, pika 1 Gazeta zyrtare e RMV. nr. 80/92, 9/96, 38/04, 33/06, 84/08, 67/10, 156/10, 39/12, 44/12, 38/14, 115/14, 104/15,

Përpos asaj kohë zgjatja e mbajtjes mundet edhe të jetë më e shkurt nëse martesë ka zgjatur për një periudhë shumë të shkurtë kohore, sa që mund edhe të refuzoj edhe plotësisht kërkesa të këtilla, duke i pasur parasysh nivelet e pasurisë a kanë ndryshuar.

2.5. Pushimi i mbajtjes

Pushimi i mbajtjes ndodh atëherë kur ndodh që kushtet e parapara në dispozitat ligjore janë përmbushur, ose nëse pas skadimit të afatit të caktuar me gjykatë bashkëshorti që merr mbajtje nuk ka paraqitur kërkesë për të vazhduar me mbajtjen, ndërsa nëse kërkesa paraqitet pas skadimit të afatit kjo kërkesë nuk merret parasysh.

Në neni 191 thuhet:

1. “ E drejta e bashkëshortit të mëparshëm për ushqim pushon kur të pushojnë kushtet nga neni 185 i këtij ligji, kur të kalojë koha për të cilin është paraparë ushqimi dhe kur bashkëshorti i mëparshëm që pranon ushqim do të lidhë martesë të re gjegjësisht do të hyjë në bashkësi jashtëmartesore.”²³

Nëse e kemi parasysh këtë nen themi që ndërprerja e apo pushimi i mbajtjes ndodh në këto raste :

- Bashkëshorti ka mjete të mjaftueshme financiare,
- Është i aftë për punë,
- Jepet mundësia për të punuar,
- Sëmundja psikike ose fizike është shëruar,
- Nëse bashkëshorti që ka për detyrë të mbaj, ekonomikisht dobësohet deri në atë mas, sa edhe veten e tij nuk mund ta mbaje,
- Kalimi i periudhës kohore gjyqësore,
- Mos paraqitja me kohë e kërkesës për vazhdim të mbajtjes,
- Martesa me një person tjetër ,
- Hyrje në një bashkësi jashtëmartesore,

²³ Po aty, neni 191,

- Vdekja e personit.

2.6. Mbajtja e fëmijëve nga prindërit e tyre

Para se të flasim për mbajtjen e fëmijës duhet të shohim një realitet se nëse e analizojmë me kujdes fenomenin e mbajtjes së fëmijëve nga prindërit e tyre e shohim se çështja e shkurorëzimeve është e përhapur si formë epidemie dhe që po rritet për çdo ditë e më shumë duke i shtuar viktimat social sikurse që janë fëmijët, për shkak se më së shumti që ndikohen në rastet e divorceve janë fëmijët, ngase ndikohen negativisht vetë fëmijët në aspektin emocional por edhe psikik, por në raste të këtilla kur kemi prindër të cilët vetëm se kanë vendosur që të vazhdojnë rrugën e tyre çdonjëri prej tyre, atëherë themi se të qenurit në bashkësi martesore ose jashtëmartesore ka mbaruar në mes tyre, por jo edhe të qenurit prind i fëmijëve të tyre, prandaj edhe në ligjin për familje në Republikën e Maqedonisë së Veriut thuhet: "Nëse bashkëshortët kanë fëmijë të mitur të përbashkët ose fëmijë të rritur mbi të cilët janë zgjeruar e drejta prindërore, është e nevojshme të paraqesin marrëveshje për mënyrën e ushtrimit të të drejtave dhe detyrave prindërore dhe për mbështetje dhe edukimin e fëmijëve."²⁴

Janë prindërit ata të cilët duhet të kujdesen për fëmijët e tyre pa marrë parasysh pëlqen apo jo, ngase ato janë frutë i tyre, dhe si të tillë kërkojnë mbështetjen e prindërve të tyre, prandaj edhe në neni 80 thuhet: " Me aktgjykim me të cilin shkurorëzohet martesa, gjykata do të vendosë për kujdesin, edukimin dhe mbajtjen e fëmijëve të zakonshëm."²⁵

Pra të gjitha të drejtat që ju takojnë fëmijëve gjykata i ndan ato që të i jepet qetësia dhe rahatia fëmijës në një far forme. Ndërsa në neni 179 të ligjit për familje paragrafi 1 thuhet: " Prindërit janë të obliguar t'i ushqejnë fëmijët e tyre."²⁶

²⁴ Ligji për familje, neni 39, Gazeta zyrtare e RMV. nr. 80/92, 9/96, 38/04, 33/06, 84/08, 67/10, 156/10, 39/12, 44/12, 38/14, 115/14, 104/15,

²⁵ Po aty, neni 80, pika 1,

²⁶ Ligji për familje, neni 179, pika 1,, Gazeta zyrtare e RMV. nr. 80/92, 9/96, 38/04, 33/06, 84/08, 67/10, 156/10, 39/12, 44/12, 38/14, 115/14, 104/15,

Ligjvënësi sikur që shihet ka vendosur shumë pika me të cilat është munduar që të rregulloj statusin e fëmijës në veçanti, që mos të shkelen të drejtat e fëmijëve dhe ajo që ju takon atyre dhe prindërve me të cilët jetojnë ato.

Kështu për mbajtjen e fëmijëve kemi dy grupe:

1. Mbajtja e fëmijëve të mitur ndër moshës 18 vjeçare.
2. Mbajtja e fëmijëve të moshës madhore.

2.6.1.Mbajtja e fëmijëve të mitur

Fëmijët e mitur konsiderohen të gjithë ato fëmijë të vegjës nga mosha 0 deri në moshën 18 vjeçare kur ligjvënësi i konsideron të gatshëm që janë aq të pjekur për të mundur të zgjedhin vetëm problemet e tyre jetësore, të janë të barabartë me qytetarët e tjerë, pra prindërit për fëmijët e moshës së mitur kanë obligim për ti mbajtur ose thënë ndryshe kanë për obligim ti pastrojnë harxhimet e tyre për veshje, ushqim, shkollim, kurse dhe gjëra tjera deri në moshën 18 vjeçare.

Në neni 46 thuhet:” Prindërit kanë të drejtë dhe obligim t’i mbajnë fëmijët e tyre të mitur, të kujdesen për jetën dhe shëndetin e tyre, t’i përgatisin ata për jetë dhe punë të pavarur, të kujdesen për edukimin e tyre, shkollimin dhe aftësinë e tyre.”²⁷

Pa marrë parasysh se prindërit janë në bashkësi apo janë shkurorëzuar ata duhet të kujdesen pr fëmijët e tyre nëpërmjet alimentacionit, si dhe nevojave tjera të cilat janë paraparë dhe që ndihmojnë në nevojën e ecjes përpara të fëmijës drejt ardhmërisë së vetë.

2.6.2.Mbajtja e fëmijëve të moshës madhore

Sa i përket mbajtjes së fëmijëve të cilët kanë mbushur moshën 18 vjeçare në ligjin për familje thuhet:

²⁷ Po aty, neni 46,

1. “Nëse shkollimi dhe arsimimi profesional i fëmijëve vazhdon edhe pas moshës madhore, prindërit janë të detyruar t’i ushqejnë edhe më tutje fëmijët e tyre deri në përfundimin e rregullt të shkollimit, e më së voni deri në moshën 26 vjeçare.
2. Nëse personi madhor është i paaftë për punë për shkak sëmundjes, të metës fizike ose psikike, ndërsa nuk ka mjete të mjaftueshme për jetë dhe nuk mund t’i fitojë nga pasuria e tij, prindërit janë detyruar të ushqejnë derisa zgjat ajo paaftës.”²⁸

Pra edhe pse fëmija mbush moshën e tij madhore kur llogaritet para shtetit i barabartë me gjithë moshatarët e tij, dhe ato që janë më të moshuar, mbajtja e tij prapë ligjvënësi e ka para parë nëse fëmija vazhdon shkollimin dhe nuk mundet edhe që të punoj edhe të shkollohet, në këtë rast prindërit obligohen që të mbajnë atë por jo më shumë se moshën 26 vjeçare, kurse një veti tjetër është që dispozitat juridike kanë para parë që edhe nëse fëmija është i moshës madhore por ka ndonjë sëmundje të përkohshme apo të përhershme, prindërit e tij detyrohen që ta mbikëqyrin dhe të mbajnë atë deri sa ai të shërohet, ose deri sa ai të jetojë me ato mangësi, sëmundje etj.

2.6.3.Përcaktimi i mbajtjes

Sa i përket përcaktimit të mbajtjes për dallim prej bashkëshortëve të fëmijët merren parasysh edhe gjëra të tjera, sikurse që është përmendur në neni 198: “Kur përcaktimi i ushqimit bëhet për fëmijë, gjykata do të marrë parasysh edhe moshën e fëmijës si dhe nevojat për shkollimin e tij”²⁹ sikurse që edhe është përmendur që merren në shqyrtim në më shumë aspekte se sa vetëm ushqimi i tij, por ka kujdes të veçantë të llogaritet edhe shkollimi i tij, kurset e ndryshme, hobe dhe shumë gjëra të tjera të cilat kanë të bëjnë me fëmijën dhe këto harxhime do shkojnë mbi njërin prind, kurse prindi tjetër si pjesë e mbajtjes do të konsiderohet edukimi dhe jeta me të apo sikurse që thuhet në nenin 195:

²⁸ Ligji për familje, neni 179, pika 2 - 3, Gazeta zyrtare e RMV. nr. 80/92, 9/96, 38/04, 33/06, 84/08, 67/10, 156/10, 39/12, 44/12, 38/14, 115/14, 104/15,

²⁹ Po aty, neni 194, pika 2,

” Në kontekstin e prindërve me ushqimin e fëmijëve, gjykata si kontribut për ushqimin e fëmijëve, prindit të cilit fëmija i është besuar për ruajtje dhe edukim, do të vlerësojë punën dhe kujdesin që ai prind e jep në edukimin dhe ngritjen e fëmijës.”³⁰

Sa i përket lartësisë që duhet ti përcaktohet prindërit për fëmijën e tij ajo mund të jetë në forma të ndryshme, ku në njërën merret parasysh edhe të hyrat, rroga dhe nga ajo caktohet lartësia e mbajtjes, por e njëjta mund të ndryshojë kohë pas kohe me kërkesë të prindërit apo Qendrës për punë sociale. Të autorizuar nga prindërit të inicioj dhe zhvillojë kontestin për realizimin e kësaj të drejte.

Gjithashtu kjo e drejtë e fëmijës që i sigurohet mund të i sigurohet vetëm në të holla dhe më pas të shfrytëzohen për aty ku ka nevojë më së shumti fëmija

³⁰ Ligji për familje, neni 195, Gazeta zyrtare e RMV. nr. 80/92, 9/96, 38/04, 33/06, 84/08, 67/10, 156/10, 39/12, 44/12, 38/14, 115/14, 104/15,

3. DETYRIMI I MBAJTJES NË KËNDVËSHTRIM KRAHASUES

3.1. Nocioni i mbajtjes sipas Ligjit për familje të Kosovës

Në Republikën e Kosovës edhe pse si shtet më i ri, apo i cili ka fituar pavarësinë e tij në kohën e fundit, por në sistemin e dispozitave ligjore është munduar që ligjvënësi të jetë në hap me kohë . Si shtet i sapo formuar që është ajo pritet të ketë sfida të mëdha në shumë aspekte të ndryshme shoqërore, por ajo që është më i rëndësishëm është garantimi i të drejtave ligjore si dhe implementimi i tyre në mesin shoqërorë që çdonjëri të fitojnë të drejtën e tij që i takon.

Por nuk duhet të harrojmë se ligjvënësi në Kosovë ka paraparë që të ketë edhe mbajtjen e familjes në përgjithësi , duke filluar nga mbajtja e bashkëshortëve në mes tyre, por edhe të fëmijëve, pra mbajtja është sigurimi financiarë në mes familjarëve në brendësi të martesës së tyre apo në një bashkësi jashtëmartesore.

Në neni 278 thuhet: “Mbajtja financiare në kuptim të këtij ligji, nënkupton detyrimin financiar dhe material.”³¹

Sipas ligjvënësit në Republikën e Kosovës me mbajtje nënkuptohet që personave që ju takon kjo e drejtë për ta dhënë ose pranuar, apo thënë edhe ndryshe debitori dhe kreditori në këtë kuptim kanë detyrimet financiare ndaj njëri - tjetrit, dhe ky detyrim nuk mbaron vetëm aty por ai vazhdon edhe më tutje duke i detyruar që përpos aspekti financiar të jetë edhe ai material, në varësi të nevojave që janë paraqitur. Kurse për plotësimin e këtyre detyrimeve se kush kënd duhet ta financoj dhe si duhet kjo të vazhdoj, në pikën e dytë të paragrafit 278 thuhet:” Të afërmit në vijë të drejtë janë të detyruar të sigurojnë mbajtje financiare.”³²

Ligjvënësi ka vazhduar edhe më tej duke vendosur edhe arsyet dhe kushtet se kur duhet të implementohet një e drejtë e këtillë si dhe ndaj kujt duhet të implementohet, pra ka kushte të cilat i garantojnë të drejtën që i takon njëres palë.

Kushtet janë sikurse në vijim:

³¹ Ligji për familje i RKS, neni 278, gazeta zyrtare nr. 4 i datës 01.09.2006, ligji nr. 2004/32

³² Po aty, neni 278,

1. Gjendja e nevojshme, ku në neni 279 thuhet:” Vetëm personat të cilët financiarisht nuk mundën ta mbajnë veten janë të pranueshëm për mbajtje financiare.”³³

2. Aftësia e shërbimit, ku në neni 280 thuhet:

”Personat të cilët duke marrë parasysh të gjitha detyrimet personale nuk janë në gjendje të sigurojnë mbajtje financiare pa rrezikuar mjetet e tyre financiare të arsyeshme nuk janë të detyruar të sigurojnë mbajtje financiare.”³⁴

Nëse këto kushte përfshihen dhe janë në momentin e paraqitjes së kërkesës atëherë atij i takon mbajtja financiare për një periudhë kohore të caktuar, pra nëse gjendja e tij ekonomike është e rëndë, kurse këtu po ashtu ligjvënësi ka paraparë që personi që duhet ta jep mbajtjen financiare apo materiale duhet të jetë në gjendje të mirë ekonomike, dhe detyrimi financiar apo material mos të ndikojë negativisht në gjendjen e tij ekonomike, dhe nëse një gjë e tillë do ndodhte që të ndikoj negativisht mbajtja te personi që duhet ta jep atëherë edhe ai lirohet nga mbajtja, dhe një veprim mund të aplikohet edhe nëse bëhet fjalë për fëmijën apo mbajtjen e tyre dhe fëmija ka mundësi ekonomike apo dikush tjetër i familjes kujdeset për mbajtjen e tij atëherë prindërit lirohen deri sa gjendja e tyre ekonomike të rregullohet.

Por nuk duhet harruar se në neni 285 ligjvënësi ka paraparë se :

1. ” Shtrirja e mbajtjes duhet të jetë adekuate me kushtet nën të cilat ka jetuar personi që ka të drejtë mbajtje. Në rast se personi ka jetuar në kushte të rënda, mbajtja duhet të sigurojë së paku minimumin që nevojitet për të mbijetuar një jetë të rëndomtë dinjitoze.”³⁵

Me këtë sigurohet që personi që duhet të jep mbajtje të mos dëmtohet, si dhe personi që i takon mbajtja të mos shpresojë që nga një jetë e mesme apo e varfër që do të jetoj në një jetë luksoze, por do merret parasysh jeta e mëhershme dhe në bazë të saj të sigurohet që më së paku ndër jetesën minimume të mos jetë pala që i takon e drejta e mbajtjes, dhe e gjitha kjo mund të realizohet duke dhënë para, përpos nëse pala që duhet ta përmbush këtë detyrim kërkon me kërkesë të veçantë[që ti mundësohet që në ndonjë formë tjetër të i mundësohet përmbushja e detyrimit të mbajtjes.

³³ Ligji për familje i RKS, neni 279, gazeta zyrtare nr. 4 i datës 01.09.2006, ligji nr. 2004/32

³⁴ Po aty, , neni 280,

³⁵ Po aty, neni 285, pika 1,

3.2. Detyrimi i mbajtjes midis bashkëshortëve

Në sistemin e Republikës së Kosovës është e vendosur edhe çështja e mbajtjes së domosdoshme të bashkëshortëve dhe për këtë në neni 71 thuhet:

“ Gjatë procedurave të kontesteve martesore, gjykata me vendim duke u bazuar në padi, mund të caktojë masa të përkohshme për sigurimin e mbajtjes financiare për bashkëshortin dhe vendosjen e tij.”³⁶

Bashkëshortët në rend të parë obligohen që të kujdesen për njëri - tjetrin edhe pas shkurorëzimit të tyre, gjegjësisht ato kujdesen që të kenë mbajtje financiare dhe vendosjen e tij apo thënë më mirë vendbanimi i tij. Ajo që ka vendosur ligjvënësi në dispozitat e tyre është se gjatë kërkesës së bërë për mbajtje financiare , bashkëshortët obligohen të sigurojnë të dhënat e tyre financiare para gjykatësit, në mënyrë që gjykatësi ta ketë sa më të lehtë në marrjen e vendimit , si dhe duke mos e shkelur të drejtën e palës tjetër. Në neni 281 thuhet: “Të afërmit në vijë të drejtë janë të detyruar, në bazë të kërkesës t’i paraqesin njëri - tjetrit të hyrat dhe gjendjen financiare.”³⁷

Në këtë mënyrë para gjykatësin janë faktet për pasqyrën e tyre financiare, dhe nëse personit që duhet të jep mbajtjen nuk ka mundësi ose ndikon negativisht një veprim ti tillë, atëherë ai sjellë para gjykatësit një dëshmi me shkrim dhe dokumente të tjera me të cilën do dëshmonte për të ardhurat financiare të tyre.

Sa i përket radhës së mbajtjes sipas dispozitave juridike të ligjit për familje në rend të parë janë bashkëshortët e më pas vazhdon radha e të afërmeve të tjerë, për këtë në neni 282 thuhet:

1. “Bashkëshorti është fillimisht i detyruar t’i jap mbajtje financiare bashkëshortit tjetër,
2. Në rast se detyrimi për mbajtje financiare ekziston ndërmjet disa të afërmeve, së pari kanë detyrim pasardhësit e pastaj të afërmit e vijës paraardhëse.
3. Detyrimi për dhënien e mbajtjes financiare për personat në gjini të gjakut caktohet sipas radhës me të cilën mund të thirren në trashëgimi.

³⁶ Ligji për familje i RKS, neni 71, gazeta zyrtare nr. 4 i datës 01.09.2006, ligji nr. 2004/32

³⁷ Po aty, neni 281 pika 1,

4. Ndërmjet disa të afërmeve të cilët janë në marrëdhënie të natyrës së njëjtë, të gjithë këta kanë detyrime në proporcion me mundësitë e tyre financiare. Personi i cili drejtpërdrejt përkujdeset për fëmijun në kujdesin e tij shtëpiak e përmbushë pjesën e tij duke siguruar kujdesin dhe shkollimin.”³⁸

Duke pasur parasysh se në vijë të parë janë bashkëshortët që duhen të kujdesen për njëri - tjetrin, e më pas të tjerët, e nëse janë të njëjtës gjini atëherë merret parasysh aspekti trashëgimtar, cili është në rend të parë që i takon trashëgimia dhe me rend, dhe nëse mbajtja bie mbi disa persona atëherë detyrimin e tyre e kryejnë sipas mundësisë që kanë.

Përpos aspektit material bashkëshortëve ju takon edhe mbajtja me ushqim të njëri tjetrit e cila mundet me qenë si shkak i papunësisë, apo edhe punësimi por mjetet e ardhura nuk i mjaftojnë për të tejkaluar nevojat e tij esenciale, pa aftësia për punë, nevojshmëria, mosha, etj. Për këtë në neni 299 thuhet: “ Bashkëshorti i ndarë mund të kërkojë ushqimin nga bashkëshorti tjetër përderisa ai do të kujdeset dhe e mban fëmijun e përbashkët dhe për këtë arsye i bëhet e pamundur të punoj.”³⁹

Gjitha këto detyrime të mbajtjes qoftë financiare apo ushqimore mund të përfundoj nëse bashkëshortët vdesin ose të tillë llogariten përpara ligjvënësit, dhe për këtë në nen 288 thuhet: “E drejta e mbajtjes ndërmjet dy bashkëshortëve përfundon nëse ndonjëri nga ata vdes”⁴⁰

3.3. Detyrimi i prindërve për t’i mbajtur fëmijët

Detyrimi i prindërve në çdo legjislacion i takojnë ndaj fëmijëve të tyre, ku ndër tjerat edhe në pikat apo detyrimet e mbajtjes, prandaj edhe në neni 290 thuhet:

1. “ Prindërit janë të detyruar të ofrojnë mbajtje financiare për fëmijët e tyre të mitur.
2. Nëse fëmiju nuk e ka përfunduar shkollimin deri në moshën madhore, prindërit kanë detyrim të ofrojnë mbështetjen e nevojshme për të siguruar shkollimin, respektivisht edukimin në fakultet deri sa fëmiju të arrin moshën 26 vjeç.”⁴¹

³⁸ Ligji për familje i RKS, neni 282, pika 1, gazeta zyrtare nr. 4 i datës 01.09.2006, ligji nr. 2004/32

³⁹ Po aty, neni 299, pika 1,

⁴⁰ Po aty, neni 288,

⁴¹ Po aty, neni 290,

Pra prindërit obligohen që të mbajnë fëmijët e tyre të mitur financiarisht dhe me përmbushjen e nevojave të tyre të cilat do të ndihmojnë në mos pasjen dallim nga bashkëmoshatarët e tjerë, pastaj edhe nëse fëmiju ka arritur moshën madhore por vazhdon se studime në nivele më të larta, atëherë prindërit e tij apo ai që duhet të realizojë të drejtën e mbajtjes obligohet që ta mbaj deri në përfundimin e saj, por jo më shumë se sa mosha 26 vjeçare.

Po ashtu prindërit obligohen edhe me mbajtjen e fëmijës së tyre edhe atëherë kur fëmija për shkak të sëmundjes qofshin fizike apo mendore nuk kanë mundësi të kujdesen për përmbushjen e nevojave të tyre financiare, sikurse që është parashikuar në ligjin për familje në Republikën e Kosovës ku thuhet: “ Nëse fëmiju i moshës madhore nuk është në gjendje të punojë për shkak të sëmundjes, të metave fizike dhe mentale, dhe i cili nuk ka sasi të mjaftueshme të mjeteve financiare për shpenzimet e tij financiare, prindërit kanë për detyrim të sigurojnë ndihmën financiare deri sa një situatë e tillë të mbarojë.”⁴²

Për dallim prej legjislacionit të familjes në Maqedoni, legjislacioni i familjes në Kosovë në neni 292 ka para parë që: “Nga mosha 15 vjeçare e tutje, fëmiju i cili fiton të ardhura me punën e tij, është i detyruar që financiarisht të kontribuoj për mbajtjen e tij dhe nëse e kërkon nevoja edhe për kontribut të arsyeshëm për mbajtjen e familjes me të cilën jeton.”⁴³

Pra nga mosha 15 vjeçare nëse fëmiju është në gjendje që të punojë, pra nuk pengon punësimi i tij asgjë në zhvillimin e tij, qoftë fizik apo psikik, apo nuk krijon rrethana me çka do të ndërpres shkollimin atëherë ai mund të punojë, kurse nga puna apo fitimi i tij personal detyrohet që të ndihmojë në kontributin e mbajtjes së vetës së tij dhe në raste të veçanta të kontribuojë edhe në ndihmë ndaj familjes me të cilën jeton ai.

Këto janë ato detyrime të cilat duhen të i plotësoj palët në mes vete, qofshin ato bashkëshortët që duhet ta mbajnë njëri tjetrin , apo prindërit që duhet ti mbajnë fëmijët e tyre si aspektin financiar, material apo financiar, dhe një mohim i këtyre detyrave do të sjellë deri në gjykime të tjera apo akuza të tjera që do hapnin procedura të tjera dhe maltretime për dy palët, për mos përmbushjet e detyrave ligjore të nxjerra nga ky ligj i Republikës së Kosovës.

⁴² Ligji për familje i RKS, neni 291, gazeta zyrtare nr. 4 i datës 01.09.2006, ligji nr. 2004/32

⁴³ Po aty, neni 292,

3.4. Detyrimi për ushqim sipas Kodit të familjes të Shqipërisë

Mbajtja e familjes, gjegjësisht të personave që obligohen me plotësimin e detyrimeve të mbajtjes edhe në Republikën e Shqipërisë është e mbrojtur me ligj dhe e paraparë në dispozitat e brendshme të saj, duke vendosur rregullin dhe respektin e të drejtave në mes çitit, fëmijëve dhe anëtarët e tjerë të familjes. Shprehja “detyrim ushqimor” nënkupton gjithçka që është e nevojshme për të plotësuar nevojat materiale dhe kulturore të jetesës, ku përfshihen ushqimi, veshja, banimi, drita, uji, shpenzime për arsimimin, shpenzime të veçanta (spitalore, etj.)”⁴⁴

Për dallim nga sistemi ligjor në Maqedoni dhe Kosovë, sistemi ligjor i Shqipërisë ka përkufizuar se kush obligohet me detyrimet e mbajtjes në ligjin për familje në neni 192 ku thuhet: “Detyrim për ushqim kanë, sipas radhës:

- a. bashkëshorti ndaj bashkëshortit tjetër dhe fëmijët ndaj prindërve të tyre;
- b. prindërit ndaj fëmijëve të tyre;
- c. të paslindurit ndaj të paralindurve të tyre, që nuk janë prindër, sipas radhës më të afërt;
- d. të paralindurit ndaj të paslindurve të tyre, që nuk janë fëmijë të tyre, sipas radhës më të afërt;
- e. vëllezërit dhe motrat ndaj vëllezërve dhe motrave të tyre, sipas radhës më të afërt;”⁴⁵

Ligjvënësi ka përcaktuar në formë të prerë se kush ndaj kujt ka obligim për dhënien e mbajtjes ose për kërkimin e mbajtjes dhe ata duke nisur nga pika e formimit familjarë, pra që janë bashkëshortët ndërmjet veti, më pas ndaj fëmijëve të tyre dhe fëmijët ndaj prindërve të tyre, më pas janë vëllezërit dhe motrat në mes tyre dhe duke vazhduar edhe me të kundërtën.

Pra për plotësimin e detyrimit ushqimor qoftë ai që përfiton këtë të drejtë e qoftë ai që duhet ta realizojë këtë të drejtë duhet t’i përkasin të njëjtës familje, në kuptimin e gjerë të vetë fjalës, detyrimi për ushqim është detyrim pa kundër shpërblim, pra përfituesi nuk duhet të bëjë apo japë ndonjë gjë si kundër shpërblim.

Kur personat e detyruar për dhënien e ushqimit nuk janë në gjendje që ta japin këtë, detyrimi u kalon tërësisht ose pjesërisht personave në radhë të më pasme. E drejta për ushqim

⁴⁴ <https://portal.tlas.org.al/sq/sherbimet/detyrim-ushqimor> e marrë me date 05.05.2023

⁴⁵ Kodi i familjes, neni 192, nr. 9062 i datës 8,5,2003, i ndryshuar dhe plotësuar nr. 134/2015

nuk mund të tjetërsohet, e as të sekuestrohet, si dhe nuk mund të kompensohet, pasi në detyrimin për ushqim përfshihen vetëm mjetet e domosdoshme për jetesë.

Por duhet të kemi parasysh se edhe këto vendime munden të pushojnë dhe të ndërpriten në raste kur:

1. “Detyrimi për ushqim pushon me vdekjen e personit të detyruar, personit që e përfiton atë, edhe sikur ky detyrim, që përmbahet në një vendim të formës së prerë, të mos jetë ekzekutuar.
2. Ndalimi i kompensimit dhe i zëvendësimit të detyrimit për ushqim.”⁴⁶

Pra me vetë vdekjen e njërit prej dy palëve , ndërpritet forma e mbajtjes, kurse nga e drejta e mbajtjes nuk mund të heqë dorë edhe nëse një gjë e tillë është e paraqitur ai është i pavlefshëm.

3.5. Detyrimi për ushqim midis bashkëshortëve

Bashkëshortët pasi kanë arritur deri në shkurorëzimin e martesës së tyre, atyre nuk ju mbaron detyrimet ndaj njëri tjetrit, dhe në këtë rast kodi për familje i Shqipërisë parasheh që bashkëshorti që është i paaftë për punë, nuk i mjaftojnë mjetet e jetesës atëherë i takon e drejta që nga bashkëshorti i tij të kërkojë për përmbushjen e detyrimit të mbajtjes, në neni 199:

1. “ Bashkëshorti që është i paaftë për punë dhe pa mjete të mjaftueshme për të jetuar, ka të drejtë të kërkojë detyrimin për ushqim nga bashkëshorti tjetër.
2. Detyrimi për ushqim kërkohet në të njëjtën kohë me padinë për zgjidhjen e martesës.
3. Kjo kërkesë mund të paraqitet edhe brenda 6 muajve, nga data që vendimi për zgjidhjen e martesës ka marrë formë të prerë, me kusht që paaftësia dhe mungesa e mjeteve të mjaftueshme për të jetuar të kenë ekzistuar gjatë martesës.”⁴⁷

Pra kodi për familje urdhëron në ndihmë të ndërsjellët në mes bashkëshortëve edhe pas momentit të prishjes së bashkëjetesës së tyre por duke pasur parasysh plotësimin e kushteve që parashihen në neni 199 si që janë:

⁴⁶ Kodi i familjes, neni 212, nr. 9062 i datës 8,5,2003, i ndryshuar dhe plotësuar nr. 134/2015

⁴⁷ Po aty, neni 199

1. Pa punësia dhe pa aftësia,
2. Kërkesa e mbetjes të jetë e paraqitur me padinë për shkurorëzim,
3. Ose në afat prej 6 muajve, pas shkurorëzimit.

E gjitha kjo vlen për një periudhë të ndarë kohore, nuk është e përhershme kjo mbajtje ndërmjet palëve, por ajo mund të zgjat deri në 6 vite më së shumti, por ndërkohë kjo martesë mund të pushojë edhe para kësaj kohe sikurse që është paraparë në dispozitat ligjore ku thuhet:” Ky detyrim pushon para këtij afati, kur bashkëshorti, që e gëzonte këtë të drejtë, lidh martesë të re ose bëhet i aftë për punë, ose siguron mjete të mjaftueshme për të jetuar, ose kur gjykata duke marrë parasysh rrethanat, çmon se nuk është i denjë për të përfituar nga kjo e drejtë.”⁴⁸

Si rrethana që e bëjnë të padenjë ish-bashkëshortin për të përfituar nga kjo e drejtë mund të jenë: ”përhapja e fjalëve poshtëruese ndaj ish-bashkëshortit, provokimi i skandaleve ndaj tij, fyerja publikisht, etj. Në këto raste heqja e detyrimit ushqimor para afatit të caktuar duhet të bëhet me vendim gjyqësor, pasi është gjykata organi kompetent që duhet të vlerësojë nëse janë vërtetuar kushtet e padenjësisë. Detyrimi i ushqimit pushon me vdekjen e personit të detyruar edhe në rastet kur ka një vendim gjyqësor të formës së prerë që nuk është ekzekutuar.”⁴⁹

3.5.1. Heqja, pakësimi ose shtimi i detyrimit për ushqim

Sa i përket ushqimit ose formës së mbajtjes ligjvënësi në Shqipëri ka paraparë si mundësi edhe heqjen e mbajtjes, pakësimin e mbajtjes, dhe shtimin e mbajtjes, dhe për këtë në neni 207 thuhet:” Gjykata, me kërkesën e personit të interesuar, mund të pakësojë, të heqë ose të shtojë detyrimin për ushqim, të caktuar me vendim të formës së prerë, kur rrethanat në bazë të të cilave është dhënë vendimi kanë ndryshuar më vonë.

Detyrimi për ushqim mund të pakësohet edhe për shkak të sjelljes së çrregullt ose të qortueshme të personit që e përfiton atë.

⁴⁸ Kodi i familjes, neni 200, pika 2, nr. 9062 i datës 8,5,2003, i ndryshuar dhe plotësuar nr. 134/2015

⁴⁹ <https://portal.tlas.org.al/sq/sherbimet/detyrim-ushqimor> e marr me date 06.05.2023

Nëse pas përcaktimit të detyrimit për ushqim konstatohet se një nga personat e detyruar në shkallë të mëparshme është në gjendje që ta japë atë, gjykata vendos zëvendësimin këtij detyrimi.

Në këtë rast, personi i detyruar në shkallën e më pasme nuk çlirohet nga ky detyrim, pa u caktuar detyrimi për ushqim ndaj personit në shkallën e mëparshme.”⁵⁰

Duke pasur parasysh nenin e lartpërmendur mund të themi se për heqjen, shtimin apo pakësimin e mbajtjes mund të ndodh vetëm me vendim të gjykatësit, kur sjellën fakte për ndryshimin e rrethanave, sikurse që është punësimi me orar të caktuar ose edhe e kundërta kur personi ka qenë në këtë gjendje dhe më pas ka mbetur pa punë, në këtë rast i bëhet shtimi i mbajtjes, por kjo nuk është i vetmi rast ngase ndonjëherë edhe për qortim për sjelljen e tij. Personat që kanë përmbushin detyrat e mbajtjes, dhe më pas arrihet mundësia e plotësimit të kësaj detyre nga vetë personi për shkak ndryshimit të gjendjes së tij, qoftë ekonomike apo shëndetësore, atëherë gjykatësi e zëvendëson vendimin e tij të më hershëm me një vendim të ri.

3.5.2. Mënyra e përmbushjes së detyrimit për ushqim

Sa i përket mënyrës së përmbushjes së detyrimit për mbajtje ne neni 209 thuhet:

1. “Personi që ka detyrimin për ushqim ka të drejtën e zgjedhjes për përmbushjen e detyrimit nëpërmjet pagesës bankare ose të drejtpërdrejtë, që parapaguhet periodikisht, ose duke e mbajtur në shtëpinë e tij atë që merr detyrimin për ushqim.
2. Gjkata, sipas rrethanave, përcakton mënyrën e dhënies së detyrimit për ushqim.
3. Në rast nevojë urgjente, gjykata vendos detyrimin për ushqim në ngarkim të njërit prej personave të detyruar. Në këtë rast, personi i detyruar ruan të drejtën e padisë së regresit ndaj personave të tjerë”⁴⁶

E drejta tij është që të zgjedh që përmbushjen e mbajtjes do të bëjë me pagesë në bankë apo me pagesës, të drejtë me personin që i është dhënë e drejta e shfrytëzimit të kësaj të

⁵⁰ Kodi i familjes, neni 207, pika 2, nr. 9062 i datës 8,5,2003, i ndryshuar dhe plotësuar nr. 134/2015

drejte, ose ta mbaj në shtëpinë e tij personin që e ushqen, e cila pagesë realizohet nën urdhrat dhe vendimin e gjykatësit i cili në bazë rrethanave të ndryshme ka sjellë deri në atë vendim.

3.6. Detyrimi për ushqim i prindërve ndaj fëmijëve

Çdo një prind ka për obligim të kujdeset për fëmijët e tyre brenda martesës dhe jashtë martesës së tyre, qoftë edhe në raste të ndarjes apo shkurorëzimit në mes prindërve, detyrat dhe obligimet e tyre kundrejt fëmijëve nuk mbarojnë, pra ato obligime duhet të përmbushen duke pasur për qëllim mbulimin e nevojave për rritje dhe edukimin e fëmijëve. Në neni 197 thuhet:

1. “Prindërit kanë detyrimin për ushqim ndaj fëmijëve të tyre, kur këta nuk kanë mjete të mjaftueshme për të jetuar.
2. Një fëmijë i mitur mund t’u kërkojë prindërve të tij detyrimin për ushqim edhe kur ka pasuri, kur të ardhurat nga pasuria dhe nga puna e tij nuk i përmbushin nevojat e tij.
3. Detyrimi për ushqim vazhdon edhe për kohën që fëmijët madhorë ndjekin shkollën e mesme ose të lartë, deri në moshën njëzetepesë vjeç .”⁵¹

Vlera nuk është përcaktuar nga dispozitat ligjore, por ajo është lënë për tu vlerësuar dhe vendosur nga gjykatësi, për arsye se çdo një familje ka nevojat e tyre edhe gjatë plotësimit të detyrimeve ligjore.

Prindërit kanë për obligim pik së pari të kujdesen për fëmijët e tyre të mitur në rend të parë duke pasur parasysh që këta fëmijë nuk kanë mjete të tyre për të jetuar apo për të siguruar vetë jetesën e tyre, por nga ana tjetër ligjvënësi ka parashikuar që edhe një fëmijë ka të drejtën e tij ligjore që të kërkojë mbajtjen e tij edhe pse te ai ekziston një pasuri, por kjo pasuri nuk i plotëson nevojat e tij të përditshme për zhvillimin dhe edukimin e tij.

Nga ana tjetër prindërit obligohen të plotësojnë edhe të përmbushin edhe detyrat e tyre për mbajtje edhe të fëmijëve të cilët konsiderohen të moshës madhore, por ato fëmijë vazhdojnë rrugën e tyre për zhvillim akademik, dhe kjo i bënë që prindërit të mbajnë detyrime për mbajtjen e tyre.

⁵¹ Kodi i familjes, neni 197,, nr. 9062 i datës 8,5,2003, i ndryshuar dhe plotësuar nr. 134/2015

Ajo që është e vërtetë është edhe se prindërit përkujdesen për fëmijët e tyre deri në moshën 25 vjeçare, për mbarimin e niveleve të studimeve të tyre, nëse fëmijët janë të aftë për punë dhe të zotit e vetës së tyre.

3.7. Nocioni i mbajtjes sipas të Drejtës italiane

Në sistemin ligjor italian ka shuma të ndryshme për ndihmën familjare në varësi të kushteve dhe marrëdhënieve ndërmjet personit që duhet ta përmbush mbajtjen dhe përfituesin e mbajtjes. Nëse e marrim parasysh kodin civil Italian mund të themi se mirëmbajtja është përkufizuar si detyrim i arsyetuar nga vështirësitë e palës tjetër. “E drejta e detyrimit ushqimor përkufizohet si një e drejtë personale ajo nuk mund të çudohet, shuhet me vdekjen e të detyruarit, nuk shuhet nëpërmjet kompensimit me të drejtën që mund të ketë i detyruari, siç parashihet në neni 447, si dhe në neni 545 i kodit të procedurës civil ku thuhet se nuk i nënshtrohet ekzekutimit të sforcuar.”⁵²

“Personi që ndodhet në gjendje të nevojshme që d.m.th. I privuar nga ajo që është e domosdoshme për të jetuar, e që nuk është në gjendje që të mbajë vetveten, duke mos patur burime pasurore dhe duke mos qenë i aftë për punë, ka të drejtë që të kërkojë mjete për të jetuar.”⁵³ Pra detyrimi i mbajtjes është dhënia e ndihmës materiale për një person që nuk është në gjendje të mbajë veten e tij, dhe i cili detyrim duhet të realizohet nga persona të caktuar të identifikuar me ligj, si pjesë e detyrës së tyre të solidaritetit familjar.

Rregullat për këtë lloj mirëmbajtjeje janë përcaktuar në nenet 433 e vijues. të Kodit Civil. Ku thuhet:

- a. “Ekziston një marrëdhënie juridike e veçantë ndërmjet personit që duhet të paguajë ushqim dhe përfituesit;
- b. Përfituesi, në pamundësi për të siguruar jetesën e tij, ndodhet në situatë nevojë.”⁵⁴

Në lidhje me ata që janë përgjegjës për të siguruar mirëmbajtjen janë, vijën në këtë formë:

1. “Bashkëshorti;

⁵² Galgano, Francesco, E drejta private, Luarasi, Tiranë, 2006, f. 913

⁵³ Po aty, f. 911

⁵⁴ https://e-justice.europa.eu/content_maintenance_claims-47-it-en.do?member=1 marr me datë 28.05.2023

2. Fëmijët, përfshirë fëmijët e birësuar, ose në mungesë të tyre, të afërmit e drejtpërdrejtë në vijën zbritëse;
3. Prindërit, ose në mungesë të tyre, të afërmit e drejtpërdrejtë në vijën ngjitëse; prindër birësues;
4. Dhëndrit dhe nuset;
5. Vjehrrit dhe vjehrrat;
6. Vëllezër e motra ose gjysmë vëllezër dhe gjysmë motra, me përparësi të parën mbi të dytën.”⁵⁵

I afërmi më i afërt sipas renditjes së mësipërme është përgjegjës për mirëmbajtjen; nëse ka më shumë se një person në të njëjtin nivel, përgjegjësia ndahet ndërmjet tyre sipas rrethanave të tyre financiare. Në mes vjehrrit, vjehrrës dhëndrit dhe nuses “detyrimet ushqimore pushojnë në qoftë se përfituesi lidhë një martesë të re ose kur kanë vdekur bashkëshortët, prej të cilëve rridhte krushqia dhe fëmijët e lindur pas tyre.”⁵⁶

Kurse për dallim prej ligjeve tjera të të drejtës ushqimore në ligjin Italian në neni 437 thuhet se :”Personi që ndodhet në gjendje nevojë, më përpara kishte dhuruar të mira materiale të tij, atëherë detyrimi ushqimor përpara se të bjerë mbi anëtarët e familjes, rëndon mbi të begatuarin.”⁵⁷

Në lidhje me shuma e pagueshme është në përpjesëtim me nevojën e personit që kërkon mbajtje dhe me rrethanat financiare të kujt do që duhet ta paguajë atë. Megjithatë, kjo lloj mirëmbajtjeje nuk duhet të kalojë shumën e nevojshme për të mbuluar nevojat themelore jetike të personit në nevojë financiare, duke pasur parasysh statusin e tij social.

Sipas nenit 443, “personi i detyruar për detyrimin ushqimor, ka të drejtë ta përmbushë atë me kompensim ushqimor periodik, ose ta pranojë dhe ta mbajë personin në shtëpinë e tij. Megjithatë, sipas rrethanave, gjykata mund të përcaktojë mënyrën e administrimit të ushqimit.”⁵⁸

⁵⁵ Galgano, Francesco, E drejta private, Luarasi, Tiranë, 2006, f. 913

⁵⁶ Po aty, f. 912

⁵⁷ Po aty, f. 913

⁵⁸ <http://www.legalsl.com/en/alimony-in-italy-italian-family-law.htm> e marr me datë 28.05.2023

3.7.1. Detyrimi i mbajtjes së prindërve ndaj fëmijëve

Sikurse në çdo shtet që është paraparë që të përmbushen detyrime e prindërve ndaj fëmijëve kur janë në bashkësi martesore po ashtu edhe në raste kur ndodh divorci në mes prindërve detyrat e tyre nuk shuhen ndaj fëmijëve të tyre, prandaj edhe termi “assegno di mantenimento i referohet mbështetjes financiare që prindërit duhet të paguajnë për fëmijët e tyre kur ata ndahen, divorcohen ose pushojnë së bashku (neni 337- të Kodit Civil).”⁵⁹

Fëmijët qoftë të lindur brenda ose jashtë martesës kanë të drejtë të mbahen nga prindërit e tyre në përpjesëtim me mjetet e tyre përkatëse dhe në përputhje me aftësinë e tyre për të punuar profesionalisht ose në shtëpi.

Nëse dy prindër ndahen, divorcohen ose pushojnë së jetuari me njëri-tjetrin, gjykata vendos që duhet të paguhet ushqimi i rregullt dhe vendos shumën në përputhje me nevojat e fëmijës, standardin e jetesës që gëzon fëmija ndërsa jeton me të dy prindërit, shumën. kohën e kaluar me secilin prind, burimet financiare të të dy prindërve dhe vlerën financiare të detyrave shtëpiake dhe të kujdesit të kryera nga secili prind.

Seksioni 1(65) i ligjit nr.76, datë 20 maj 2016 (rregullorja për shoqëritë civile ndërmjet personave të së njëjtës gjini dhe bashkëjetesë) “përcakton se, në rast se dy ortakë pushojnë së jetuari me njëri-tjetrin, gjykata vendos e drejta e njërit ortak për të marrë pagesa ushqimore nga partneri tjetër kur ai ose ajo është në vështirësi financiare dhe nuk është në gjendje të fitojë jetesën e tij. Në këto raste, ushqimi jepet për një periudhë kohore në përpjesëtim me kohën që kanë jetuar partnerët me njëri-tjetrin dhe në përputhje me nenin 438(2) të Kodit Civil.

Për të përcaktuar renditjen e personave të detyruar të paguajnë ushqim, siç përcaktohet në nenin 433 të Kodit Civil, detyrimi i një partneri që bashkëjeton për të paguar ushqimin ka përparësi mbi atë të vëllezërve dhe motrave.”⁶⁰

Në Itali, prindërit janë të detyruar ligjërisht t'i mbështesin fëmijët e tyre derisa ata të jenë ekonomikisht të pavarur, domethënë edhe kur fëmijët janë në moshë madhore dhe nuk jetojnë

⁵⁹ https://e-justice.europa.eu/content_maintenance_claims-47-it-en.do?member=1 e marr me datë 29.05.2023

⁶⁰ Po aty, e marr me datë 29.05.2023

më me prindërit e tyre. Detyrimi për mbështetjen e fëmijës mund të pezullohet nga një gjyqtar kur prindërit provojnë se fëmija i tyre i rritur nuk po kërkon në mënyrë aktive një punë.

Pasi një fëmijë që ka arritur moshën madhore është bërë financiarisht i pavarur, “nëse ai përsëri përjeton vështirësi financiare, prindërve nuk do t’u kërkohej përsëri të paguajnë mirëmbajtjen, por në vend të kësaj do të jenë përgjegjës vetëm për 'assegno alimentare'. Nëse një fëmijë që ka arritur moshën madhore ka një paaftësi të rëndë, zbatohen rregullat për fëmijët që janë të mitur.”⁶¹Pra këto janë detajet elementare me të cilat parasheh ligji italian për mbajtjen e fëmijëve nga ana e prindërve.

3.7.2. Detyrimi i mbajtjes midis bashkëshortëve

Në kodin civil Italian mbajtja e detyrueshme e bashkëshortëve njihet si Assegno di mantenimento e cila nënkupton “dhënia e ndihmës financiare nga një bashkëshort për tjetrin në rast ndarjeje dhe është krijuar për të siguruar që kushdo që e merr atë të jetë në gjendje të ruajë standardin e jetesës që gëzon gjatë martesës.”⁶²

Detyrimi i mbajtjes mundet të ndodh edhe atëherë kur bashkëshorti është i aftë për punë, por për arsye se të ardhurat mujore nuk i mjaftojnë për të mbijetuar apo të ketë një jetë standarde në këtë rast bashkëshorti që është në këtë gjendje kërkon nga bashkëshorti tjetër që të ndihmojë me jetesën e tij për një periudhë kohore.

Duke qenë se ky lloj mbajtjeje synon të sigurojë që bashkëshorti të mbajë një standard jetese të ngjashëm me atë që gëzonte përpara ndarjes, zakonisht është një shumë më e lartë se assegno alimentare .

Megjithatë, assegno di mantenimento nuk i paguhet bashkëshortit që konsiderohet përgjegjës për ndarjen.

Në rast divorci, gjykata mund t’i japë mbajtjen bashkëshortit të cilit i mungojnë mjetet e mjaftueshme ose në çdo rast nuk është në gjendje t’i sigurojë ato për arsye objektive, duke marrë parasysh të ardhurat e bëra nga të dy bashkëshortët, arsyet e vendimit, si dhe

⁶¹ https://e-justice.europa.eu/content_maintenance_claims-47-it-en.do?member=1, e marr me datë 29.05.2023

⁶² Po aty, e marr me datë 29.05.2023

kontributet personale dhe financiare të secilit bashkëshort në administrimin e familjes dhe pasurive të tyre, faktorë këta të vlerësuar në bazë të kohëzgjatjes së martesës.

E drejta e detyrimit për mbajtje përfundon kur përfituesi rimartohet ose krijon një familje të re. Megjithatë, me anë të vendimit “nr. 18287 të datës 11 korrik 2018, Dhomat e Bashkuara të Gjykatës së Lartë të Kasacionit (SupremaCorte di Cassazione) përjashtuan mundësinë e assegnodivorzile duke qenë vetëm me natyrë të bazuar në mirëmbajtje, pasi konstatoi se kjo formë kompensimi duhej të shërbente jo vetëm për një funksion mbështetës, por edhe, në të njëjtën masë, një funksion kompensues/barazues.

Rrjedhimisht, që të jepet kjo kompensim, duhet të miratohet një kriter i përbërë, i cili, në dritën e vlerësimit krahasues të gjendjeve përkatëse financiare/pasurore, i kushton rëndësi të veçantë kontributit të dhënë nga ish-bashkëshorti që kërkon bashkimin e pasuritë e përbashkëta dhe personale, në lidhje me kohëzgjatjen e martesës, të ardhurat e mundshme në të ardhmen dhe moshën e marrësit.”⁶³

Detyrimi i mbajtjes mund të paguhet nga njëri bashkëshort te tjetri, dhe gjithashtu nga njëri partner civil ndaj tjetrit: në rastin e fundit, palëve do t'u duhej të kishin hyrë në një shoqëri civile sipas “ligji nr. 76 i 2016 që rregullon formimi i familjeve nga persona të së njëjtës gjini.”⁶⁴

Duke pasur parasysh që në kodin civil Italian përfshihet përpos martesës në mes dy gjinive, aty kanë vendosur edhe martesën në mes gjinisë së njëjtë si e drejtë e individëve, prandaj edhe në rast të shkurorëzimit apo divorcit në mes çiftit qofshin të gjinisë së kundërt qofshin të të njëjtës gjini ju takon e drejta e plotësimit apo të detyrimit të mbajtjes ndaj bashkëshortit tjetër.

⁶³ https://e-justice.europa.eu/content_maintenance_claims-47-it-en.do?member=1, e marr me datë 30.05.2023

⁶⁴ Po aty, e marr me datë 30.05.2023

4. ROLI I ORGANEVE SHTETËRORE NË ZBATIMIN E DETYRIMIT TË MBAJTJES

4.1. Roli i gjykatës në zbatimin e detyrimit të mbajtjes

Sa i përket rolit të gjykatësit në çështjen e mbajtjes së detyrimeve është në një nivel shumë të lartë për shkak se është organi kryesor me të cilin vendoset mbajtja e tij në formën më ligjore dhe si e tillë parasheh vendosjen e kushteve, kohës dhe mënyrës së realizimit të mbajtjes, dhe nëse shohim realitetin që kemi në ditën e sodit mund të them lirisht se sikurse mos të ishte gjykatësi i paraparë në dispozitat ligjore me të vërtet çështjen e mbajtjes në mes bashkëshortëve nuk do të realizohej në pjesën më të madhe të rasteve por kam frik se edhe mbajtja ndaj fëmijëve nuk do të realizohej, por me vendosjen e ligjit në fuqi duke mundësuar që një veprim i këtillë të jetë i plotfuqishëm vetëm se me sjelljen e vendimit nga ana e gjykatësit.

Për të sjellë një vendim të këtillë duhet të ketë parasysh faktet në të cilat bazohet dhe të cilat do të ndihmojnë gjykatësin të sjellë vendimin më të përshtatshëm për dy palët, kushtet dhe kriteret të cilat i kemi përmendur edhe më herët janë bazë me të cilën gjykatësi vendos mbi procedurën në fjalë sikurse që ceket në neni 185:

“Bashkëshorti i cili nuk ka mjete të mjaftueshme për ushqim dhe është i paaftë për punë ose është i papunë pa fajin e vet, ka të drejtë në ushqim nga ana e bashkëshortit të vet në proporcion me mundësit e tij.”⁶⁵

Pra duke i pasur parasysh këto kushte të cilat duhet të i ketë personi që kërkon mbajtje gjykatësi luan një rol të veçantë për vendosjen e tyre, në fakt në shqyrtimin e këtyre kushteve se a është me të vërtet nevoja për dhënien e mbajtjes bashkëshorti i cili e ka kërkuar atë, apo ndoshta ai është i aftë për të punuar fizikisht dhe psikikisht, por një gjë të tillë nuk e dëshiron, apo ndoshta bashkëshorti ka qenë në punë dhe për shkak të fajit të tij është larguar dhe tani ka paraqitur kërkesë për mbajtje ku nuk duhet të mohojmë që bashkëshorti vetëm për ta gëzuar të drejtën e mbajtjes ka qenë fajtor në largimin e tij nga puna, dhe në këtë rast gjykatësi i sheh

⁶⁵ Ligji për familje, neni 185 pika 1, Gazeta zyrtare e RMV. nr. 80/92, 9/96, 38/04, 33/06, 84/08, 67/10, 156/10, 39/12, 44/12, 38/14, 115/14, 104/15,

dhe i hulumton në përpikshmëri këto rrethana deri në sjelljen e vendimit ose sikurse që thuhet në paragrafin e dytë të këtij neni 185:

“Gjykata mund, duke i marrë parasysh të gjitha rrethanat e rastit, ta refuzojë kërkesën për ushqim në qoftë se këtë e kërkon bashkëshorti i cili me qëllim të keq ose pa shkaqe të arsyeshme e ka braktisur bashkëshortin nga i cili kërkon ushqim.”⁶⁶

Pra roli i gjykatësit është shumë i rëndësishëm në këto pikëpamje, ngase shumë herë munden që bashkëshortët ta rëndojnë njëri - tjetrin vetëm shkaku i inateve dhe mërive të bëjnë kërkesa për mbajtjen nga pala tjetër, dhe në këtë rast gjykatësi në bazë të kompetencave që i janë besuar duhet të sjellë faktet e vërteta duke respektuar të drejtën e çdonjërit prej tyre dhe duke ndaluar dëmin për të ja shkaktuar njëri tjetrit.

Gjykatësi ka një kujdes të veçantë në përcjelljen e afateve kohore për parashtrimin e kërkesave e cila mundet me qenë në kohën kur ndodh shkurorëzimi ose një vit pas saj, por jo më shumë se kaq, dhe nëse parashtruesi i kërkesave kalon këtë periudhë kohore atëherë gjykatësi e ndalojnë një veprim të tillë, për arsye të tejkalimit të kohës.

Po ashtu gjykatësi ka të drejtën e tij që nëse bashkëshorti është paraqitur në forma të ndryshme të dhunës qoftë ajo edhe me ofendime të ndryshme të vrazhda atëherë sipas neni 187 thuhet:

“Gjykata mund që të refuzojë kërkesën për ushqim nëse këtë e kërkon bashkëshorti i cili pa shkak serioz është sjellë në mënyrë të vrazhdë dhe të pa drejtë në bashkësinë martesore ose kërkesa e tij do të paraqiste padrejtësi evidente për bashkëshortin tjetër.”⁶⁷

Roli i gjykatësit është shumë i madh gjatë procedurave të dhënies së mbajtjes në mes bashkëshortëve ose fëmijëve edhe pse ajo parashihet me dispozita ligjore, por duke pasur parasysh kushtet të cilat duhet të përmbushin palët qoftë ai që kërkon që të mbahet por edhe ai që duhet të realizojë këtë kërkesë, është e gjitha në kompetencat e gjykatësit i cili duke u bazuar në faktet reale sjelle vendime për respektimin dhe përmbushjen e të drejtave në mes bashkëshortëve dhe fëmijëve të tyre si dhe në mes tyre.

⁶⁶ Ligji për familje, neni 185 pika 2, Gazeta zyrtare e RMV. nr. 80/92, 9/96, 38/04, 33/06, 84/08, 67/10, 156/10, 39/12, 44/12, 38/14, 115/14, 104/15,

⁶⁷ Po aty, neni 187,

4.2. Gjkata supreme në zbatimin e detyrimit të mbajtjes

Gjkata supreme është organ më i lartë për nga përbërja e tij, si një institucion publik që përfaqëson instancën më të lartë gjyqësore, me juridiksion në gjithë territorin e vendit, ka për synim jo vetëm fuqizimin e këtij autoriteti, duke dhënë drejtësi, dhe që do t'i përmbushë nevojat e qytetarëve për qasje më të mirë në drejtësi, kualitet dhe ofrimin e shërbimeve me kohë dhe pa vonesa. Gjkata Supreme e Republikës së Maqedonisë është gjykata më e lartë në Republikën e Maqedonisë që siguron uniformitet në zbatimin e ligjeve nga gjykatat.

Sipas Kushtetutës së Republikës së Maqedonisë, "Gjkata Supreme e Republikës së Maqedonisë është gjykata më e lartë në Republikë dhe siguron unitetin në zbatimin e ligjeve nga gjykatat."⁶⁸

Gjkata e Lartë, si gjykata më e lartë në vend, është kompetente: të vendosë në shkallë të dytë kundër vendimeve të këshillave të saj kur është e përcaktuar me ligj;

1. Të vendosë në shkallën e tretë dhe të fundit për ankesat kundër vendimeve të gjykatave të apelit;
2. Të vendosë për mjetet e jashtëzakonshme juridike kundër vendimeve të formës së prerë të gjykatave dhe vendimeve të këshillave të saj, kur kjo është e përcaktuar me ligj;
3. Të vendosë me kërkesë të palëve dhe pjesëmarrësve tjerë në procedurë për shkeljen e së drejtës për gjykim në afat të arsyeshëm, në procedurë të përcaktuar me ligj para gjykatave në Republikën e Maqedonisë, në pajtim me rregullat dhe parimet e përcaktuara me Konventa Evropiane për të Drejtat e Njeriut dhe për të kryer detyra të tjera të përcaktuara me ligj.

Duke i pasur parasysh këto obligime dhe shumë të tjera me të cilat duhet të udhëheq gjykata supreme, themi se edhe çështja e mbajtjeve kur ndonjëra prej palëve nuk është i kënaqur me vendimin e sjellur nga gjykatësi ose kërkohet rritja apo zvogëlimi i përmbushjes së detyrave që dalin nga aktvendimi i sjellur prej më herët nga gjykatësi, atëherë kërkesa i drejtohet gjykatës supreme duke e ditur që edhe gjykata supreme për sjelljen e vendimit final, do të kaloj gjithë procedurën duke i rishikuar faktet dhe argumentet që dalin nga çështja, por

⁶⁸ Kushtetuta e Republikës së Maqedonisë, neni 101, nr. 08-4642/1 i datës 17. 11.1991

në fund sjella e vendimit do jetë final dhe i plotfuqishëm, për arsye se është sjellur nga organi më i lart që ekziston në këtë drejtim.

Nëse shohim në këtë drejtim dhe e marrim çështjen kur bashkëshorti kërkon rritjen e mbajtjes apo zvogëlimin e mbajtjes për arsye të ndryshme ose për shkak se aktgjykimi i shkallës së parë është shfuqizuar disa herë atëherë me kërkesë të paditësit gjykata supreme në të njëjtin aktgjykim mund të sjellë shumën për mbajtje duke e ndryshuar atë për çdo muaj apo duke sjellë vendime të pagesës së ndryshme për çdo muaj deri sa të sjellët një aktgjykim i plotfuqishëm i cili do të vlej për në të ardhmen dhe i njëjti do të arsyetojë vendimet e deri tanishme për mbajtje, por nëse një veprim i tillë është realizuar nëpërmjet gjykatës së shkallës së parë atëherë pala kundërshtare ka të drejtë në ngritjen e një kundër padie për mos rritjen e shumës apo ndërprerjes së mbajtjes deri në shkallën e gjykatës supreme, ku vendimi i marr do jetë përfundimtar për të dy palët, duke pasur parasysh neni 201 ku thuhet:” Personi i interesuar mund të kërkojë që gjykata ta rrisë, zvogëlojë apo ta ndërpresë ushqimin e përcaktuar më herët me aktgjykim të plotfuqishëm nëse kanë ndryshuar rrethanat në bazë të të cilave është sjellë aktgjykimi.”⁶⁹

4.3. Roli i Qendrës për punë sociale në zbatimin e detyrimit të mbajtjes

Roli i qendrës për punë sociale ka një rol të madh në mbikëqyrjen e procesit të shkurorëzimit si në rend të parë duke u munduar që të arrijnë deri në pajtimin e tyre, dhe nëse një gjë e këtillë nuk arrihet atëherë kemi procesin tjetër atë të mbikëqyrjes për çështjet e ndarjes së fëmijës, mbajtjes së fëmijëve nga ana e prindërve si dhe vetë bashkëshortët në mes tyre. E gjitha kjo kalon nëpërmjet qendrës për punë sociale duke pasur kujdes në respektimin e të drejtave të njëri tjetrit, por edhe duke përmbushur detyrat individuale. Në neni 14-a thuhet:

1. “Qendra për punë sociale është e obliguar të mbajë evidencë për personat e vënë nën kujdestari, masat e marra për kujdestarinë dhe pasurinë e personit nën kujdestari”⁷⁰

⁶⁹ Ligji për familje, neni 201, Gazeta zyrtare e RMV. nr. 80/92, 9/96, 38/04, 33/06, 84/08, 67/10, 156/10, 39/12, 44/12, 38/14, 115/14, 104/15,

⁷⁰ Po aty, neni 14-a,

Pra shihet qartë se roli i qendrës për punë sociale është i madh në vetë socializmin dhe rregullimin e jetës së personave të ndryshëm të cilët kanë arritur deri në atë shkallë që qendra për punë sociale të tregoj kujdes të veçantë për to, kurse në neni 11 thuhet:

1. "Ushqimi është e drejtë dhe detyrë e prindërve, fëmijëve dhe të afërmeve të tjerë të përcaktuar me këtë ligj, si dhe personave që jetojnë në bashkësi martesore ose jashtëmartesore.
2. Nëse personat nga paragrafi 1 i këtij neni nuk mund ta sigurojnë mbajtjen, Republika u siguron anëtarëve të familjes së pasiguruar mjetet e nevojshme për mbajtje, në kushtet e përcaktuara me ligj."⁷¹

Pra nëse respektohet mbajtja sipas renditje së përcaktuar dhe ajo nuk mundet të realizohet atëherë ajo përcaktohet nga vetë shteti duke e zgatur dorën e saj dhe duke e vendosur nën mbikëqyrjen e vetë personin që ka nevojë duke i siguruar në këtë mënyrë kushtet elementare për të jetuar të cilat janë paraparë edhe nga vetë ana dhe dispozitat ligjore.

Përpos këtyre qendra për punë sociale mund të kërkoj rritjen e kostove të fëmijëve sikurse që thuhet në neni 197:

1. "Qendra për punë sociale mund të iniciojë kontest për ushqim në emër të fëmijës së mitur, gjegjësisht për rritje të ushqimit, kur prindi me të cilin kujdeset dhe rritet fëmija nuk e shfrytëzon këtë të drejtë pa arsye të arsyeshme.
2. Nëse prindi nuk kërkon ekzekutimin e mbajtjes së dhënë, qendra për punë sociale mund të paraqesë propozim për përmbarim në emër të të miturit."

Qendra për punë sociale e shfrytëzon këtë të drejtë për rritjen e ushqimit ndaj personit i ili duhet të plotësoj këtë të drejtë, edhe nëse prindër i cili kujdeset për fëmijën nuk kërkon një gjë të tillë, duke propozuar që të bëhet një rritje të mbajtjes për arsye se një gjë të tillë ka nevojë vetë fëmija.

Po ashtu qendra për punë sociale nuk e ka vetëm se këtë obligim ajo gjithashtu do të mundohet që prindërit të arrijnë një marrëveshje në mes prindërve për mbulimin e nevojave të fëmijëve, pra është qendra ajo që mundohet që në maksimum të mbroj të drejtat dhe interesat e vetë fëmijës, sikurse që edhe thuhet në neni 198:

⁷¹ Ligji për familje, neni 11, Gazeta zyrtare e RMV. nr. 80/92, 9/96, 38/04, 33/06, 84/08, 67/10, 156/10, 39/12, 44/12, 38/14, 115/14, 104/15,

1. "Qendra për Punë Sociale do të përpiqet që prindërit të arrijnë një marrëveshje për mbështetjen e fëmijës, gjegjësisht të rrisin kontributin në mbështetjen e fëmijës kur këtë e kërkojnë nevojat e shtuara të fëmijës ose përmirësimi i rrethanave materiale të fëmijës. ofruesi i mbështetjes e bëjnë të mundur."⁷²

Një ashtu Qendra për punë social e kujdeset edhe për personat e mëshuar kur paraqitet nevoja për mbrojtjen e të drejtave të tyre, nëse një veprim t[ë] tillë nuk e realizojnë personat të cilët janë të detyruar nga ana e ligjvënësit, për këtë në neni 199 thuhet

1. "Qendra për punë sociale mundet me prokurë të të moshuarve në emër të tyre të ngrejë dhe menaxhojë kontest për realizimin e të drejtës në mbështetje kundër personave të cilët sipas dispozitave të këtij ligji janë të detyruar t'i mbështesin ata."⁷³

Kurse në neni 200 thuhet:

1. "Personi i cili është i detyruar të sigurojë ushqim, përveç detyrimit të prindit ndaj fëmijëve të mitur, me zgjedhjen e tij mund të paguajë një shumë të caktuar parash në emër të ushqimit, ose personi mund ta marrë për mbajtje në vendin e tij ose të sigurojë atë me mirëmbajtje në një mënyrë tjetër.
2. Personi që ka të drejtën e mbështetjes mundet, për arsye të justifikuara, të kërkojë që mbështetja të jepet vetëm në para."⁷⁴

Pra përpos obligimit të cilin e kanë prindërit ndaj fëmijëve të tyre ata mund të kujdesen edhe ndaj personave të tjerë në forma të ndryshme sikurse që është caktimi në një shumë të caktuar të holla, apo duke e mbështetur me qëndrim afër vetes, në mënyrë që të ja lehtësoj dhe të plotësoj obligimin e tij para ligjvënësit, por edhe mund të kërkoj që mbështetjen ta realizojë vetëm në të holla, dhe i gjithë ky proces mund të realizohet vetëm nën mbikëqyrjen e Qendrës për punë sociale, prandaj edhe themi se ky institucion ka rolin më të madh në aplikimin dhe mbarëvajtjen e kësaj të drejte.

⁷² Ligji për familje, neni 198, Gazeta zyrtare e RMV. nr. 80/92, 9/96, 38/04, 33/06, 84/08, 67/10, 156/10, 39/12, 44/12, 38/14, 115/14, 104/15,

⁷³ Po aty, neni 199,

⁷⁴ Po aty, neni 200

4.4. Raste nga praktika gjyqësore

1. K.K. dhe M.J kanë lidhur martesë në vitin 2005. Në vitin 2009 kanë lindur bineqtë J.K. dhe Z.K. Bashkëshorti K.K. ka pasur firmë private që merrej me veprimtari ndërtimore, ndërsa gruaja e tij M.J. ka punuar si mësuese në shkollë të mesme. Pas disa vitesh, ajo sëmuret nga një sëmundje e rëndë, nga e cila mbeti pjesërisht e paralizuar dhe me aftësi të zvogëluara për punë, prandaj u detyrua që ta braktisë punën dhe të mbetet pa punë. Bashkëshorti martesorë K.K. në vitin 2013 propozoi që të parashtrijnë propozim me marrëveshje për shkurorëzim të martesës, me ç'rast të dy fëmijët do të mbeteshin për ruajtje dhe edukim tek ai. Bashkëshortja e tij martesore u pajtua me këtë, por njëkohësisht kërkoi nga gjykata që t'i përcaktojë mbajtje, që duhet ta paguaj bashkëshorti i saj pas shkurorëzimit të martesës. Në këtë rast gjykata duhet të pranojë kërkesën dhe të përcaktojë mbajtjen për shkak se bashkëshortja martesore, e cila nuk ka mjete të mjaftueshme për jetesë dhe është e paaftë për punë ose është e papunë pa fajin e saj ka të drejtë në mbajtje nga bashkëshorti martesor i mëparshëm në përpjesëtim me mundësit e tij. Nëse janë plotësuar kushtet ligjore për mbajtje gjykata do të përcaktojë edhe lartësinë e mbajtjes, e cila do të varet nga mundësit materiale të bashkëshortit, i cili duhet të jep mbajtjen. Nëse gjykata konsideron se ka bazë për përcaktimin e mbajtjes në pajtim me dispozitat ligjore ajo mund ta përcaktojë për një periudhë kohore jo më të gjatë se 5 vjet pas shkurorëzimit të martesës. Nëse mbajtjen e kërkon bashkëshorti martesor, i cili është sjellë në mënyrë të pahijshme në bashkësinë martesore ose nëse kërkesa e tij do të ishte padrejtësi ndaj bashkëshortit tjetër, atëherë gjykata mund të refuzojë kërkesën për mbajtje të bashkëshortit tjetër. Të drejtën për mbajtje gjykata mund ta vazhdojë edhe pas afatit të parashikuar nëse vërteton se për këtë ekzistojnë shkaqe të arsyeshme dhe veçanërisht nëse edhe pas kalimit të afatit të caktuar bashkëshorti martesor i pasiguruar nuk është në gjendje që

të sigurojë vetë mbajtjen. Megjithatë, e drejta për mbajtje e bashkëshortit martesor të mëparshëm do të pushojë kur të pushojnë kushtet e saj.”⁷⁵

2. Vendimi i Gjykatës Themelore Civile të Shkupit. XIII. P2-283/19 dt.27.06.2019

Paditësja A. M. e përfaqësuar nga nëna e saj R.M. ndaj të paditurit R.Z. kanë ngritur akuzë për plotësimin e detyrimit të mbajtjes, duke pasur parasysh dispozitat ligjore të cilat obligojnë plotësimin e detyrimeve të prindërve ndaj fëmijëve të tyre. R.M dhe R.Z. kanë përfunduar martesën e tyre në vitin 23.06.2011 sipas vendimit të Gjykatës Themelore 2, Shkup, por tre ditë pas vendimit të shkurorëzimit R.M. ka lindur A.M. kurse personi R.Z. e ka pranuar si fëmijë të tij A.M. dhe është babi i saj legjitim para organeve shtetërore. Fëmija në këtë rast i është kujdesi prindërorë nënës së saj R.M. kurse babai saj R.Z. nuk ka dhënë asnjë kontribut ndaj fëmijës së tij në asnjë mënyrë të mundshme. Nëna në këtë rast është martuar dhe ka edhe një fëmijë tjetër, kurse jetesa e saj është prej ndihmës sociale pre 6.800.00 dinar, kurse për ish - bashkëshortin e saj nuk ka informata për të ardhurat e tij mujore, punën , aftësinë etj. Duke pasur parasysh neni 46 dhe 179 të ligjit për familje ku parashihen obligimet e prindërve ndaj fëmijëve të tyre, gjykata sjelli vendim se i padituri R.Z. të paguaj për çdo muaj nga 2000 dinar si ndihmë për mbajtjen e fëmijës e cila duhet më së voni të realizohet deri me 05 e çdo muaji.

3. Vendimi i Gjykatës Themelore Civile të Shkupit. XXIV.P2 nr.459/17 dt.06.03.2018

S.D ka paditur V.D. për mbajtje ushqimore si pjesë e detyrimeve për mbajtje të fëmijëve nga prindërit e saj, ku paditësja S.D. është e bija e V.D.

V.D. dhe Z.D. kanë qenë të martuar deri më 15.02.2017 ku edhe janë divorcuar dhe si fryt i kësaj martese ka qenë edhe e bija S.D., e cila pas shkurorëzimit ka vendosur që të jetojë me babin e saj dhe është studente në Fakultetin Pedagogjik, duke pasur parasysh se prindërit janë të obliguar për të kujdesur për fëmijët e tyre deri në moshën 26 vjeçare nëse ato janë në studime, në këtë rast S.D. ka kërkuar nga e ëma e saj që të bëjë një pagesë prej 3000 dinarëve. Pas vërtetimeve të fakteve dhe argumenteve që V.D. është e

⁷⁵ Zendeli Emine, Selamni - Bakiu, Arta, Mickoviq, Dejan, Ristov, Angel, E drejta familjare, Tetovë 2020, f. 338

ëma e S.D. si dhe kjo është studente në studime bachelore, kurse babai i saj në vitin 2017 ka pasura të ardhura bruto prej 15.065.00 dinar dhe vëllai i saj ka pasur të ardhura prej 12.000.00 dinar, kurse nëna V.D. nuk ka punë të siguruar dhe jeton me një shtëpi me vëllain e saj dhe familjen e tij, kështu që gjyqi sjelli vendim se e ëma V.D. për shkak mundësive të saja të paguaj nga 1.500.00 dinar për çdo muaj vajzës së saj S.D. duke pasur parasysh se dy prindërit do të kontribuojnë për mbajtjen e fëmijëve dhe deri sa e paditura të fillojë një punë të rregullt obligohet ta plotësojë këtë vendim të gjykatës.

4. Vendimi i Gjykatës Themelore Civile të Shkupit. 4c. P2-1425/19 dt.22.09.2020

Personat G.R. dhe L.R. kanë qenë të martuar dhe në martesën e tyre kanë pasur dy fëmijë vajza, në momentin kur në mesin e bashkëshortëve nuk ka ekzistuar mundësia për jetës të përbashkët kanë vendosur që të divorcohen, ku vajzat i janë dhënë në mbikëqyrje dhe kujdesej nënës së tyre L.R. kurse babai i tyre është obliguar që në bazë të vendimit të gjykatës P2-961/13 të datës 12.02.2014 të paguaj një shumë prej 1.800.00 dinar për vajzat në veçanti apo 3.600.00 denar në përgjithësi.

Në vitin 2020 është ngritur padi ndaj G.R. nga paditësja M.R. dhe A.R. të përfaqësuar nga e ëma e tyre L.R, ku është kërkuar që i padituri që të rritet vlera e mbajtjes ndaj fëmijëve të tyre, për arsye se nga sjellja e vendimit deri në momentin e padisë kanë kaluar 5 vite e 10 muaj dhe të ardhurat nuk janë të mjaftueshme për ti plotësuar kërkesat e vajzave, ku vajza M.R. është në moshë 15 vjeçare kurse vajza A.R. është në moshë 8 vjeçare, dhe mbajnë kurse, sporte dhe aktivitete të tjera, kurse përfaqësuesja e tyre ka të ardhura prej 15.000.00 denar, dhe nuk janë të mjaftueshme për ti plotësuar të gjitha nevojat e vajzave. Prandaj përfaqësuesja e tyre ka kërkuar një rritje prej 6.000.00 denarve për çdonjërën prej vajzave, por një kërkesë të tillë e ka refuzuar i padituri duke shprehur se është e arsyeshme kërkesa për rritje të shumës për mbajtje të fëmijëve, por është e pa arsyeshme kërkesa nga 6.000.00 denar, prandaj ai afroi që mundësia e tij për rritje të shumës është 2.500.00 den. veçmas për çdonjërën prej vajzave ose 5.000.00 denar në përgjithësi.

Gjykata në këtë rast duke i shqyrtuar faktet reale sjellë vendim që bazë të nenit 201 dhe 194 të ligjit për familje, që i padituri të bëjë pagesë prej 3.000.00 den. për çdonjërën prej vajzave ose në përgjithësi një shumë prej 6.000.00. den. duke filluar prej ditës që është ngritur padia.

5. Vendimi i Gjykatës Themelore Civile të Shkupit. 13.P2-519/19 dt.07.09.2020

Paditësi J.T. dhe e paditura M.T-M. kanë lidhur kurorëzim me 15.06.2007 në Shkup, dhe në brendësi të kësaj martese kanë pasur dy fëmijë, për shkak prishjes së marrëdhënieve bashkëshortore vendosin që të shkurorëzohen që dy bashkëshortët, dhe fëmijët do ti besohen nënës së tyre, pra bashkëshortes, kurse babi i tyre do të jep alimentacion prej 3.500.00 denar për çdonjërën prej fëmijëve më së voni deri me të 15 të çdo muaji, kurse e paditura është në pajtim me shkurorëzimin por kërkon nga i padituri që të paguaj alimentacion prej 5.000.00 denar për çdonjërën prej fëmijëve.

Gjykata pasi i shqyrtoi të gjitha faktet dhe vërtetoi gjendjen e tyre ku shihej se palët kishin një martesë 13 vjeçare dhe si rrjedh e saj kishin dy fëmijët e tyre M.T 11 vjeçare vajzë dhe A.T. 9 vjeçar djalë, në momentin e kërimit të divorcit fëmijët dhe bashkëshortja jetojnë në shtëpinë e tyre, kurse paditësi jetonte me qira. E paditura ka të hyra mujore prej 36.690.00 denar nga puna e saj me orar të rregullt, kurse paditësi po ashtu është në marrëdhënie pune të rregullt me të ardhura mujore prej 22.000.00. Denar. Që të dy bashkëshortët kanë marr kredi nga banka për të rinovuar shtëpinë e tyre. Nga parashtrimi i padisë paditësi nuk kontribuon për alimentacionin e fëmijëve, të cilët i mban plotësisht e paditura. Nga raporti i Qendrës për Punë Sociale rezulton se ekipi i ekspertëve është i mendimit që kujdestaria e fëmijëve të vazhdojë t'i besohet nënës, ndërsa babai të vazhdojë të përmbushë të drejtat dhe detyrimet prindërore. Gjykata vendosi se janë plotësuar kushtet për shkurorëzimin e martesës për shkak se gjatë procedurës gjyqësore u vërtetua se marrëdhëniet bashkëshortore janë çrregulluar aq sa jetesa e përbashkët është bërë e pamundur.

Sa i përket kujdesit të fëmijëve gjykata vendosi të merr parasysh mendimin e Qendrës për Punë Sociale që fëmijët të mbesin nën mbikëqyrje të nënës kurse babai të paguaj

alimentacion në vlerë prej 4.000.00 denar për çdonjërin prej fëmijëve apo në totale 8.000.00. den, dhe vendimi i këtillë do vlente deri në ndryshim të rrethanave në të ardhmen. E kontestueshme mes palëve nuk ishte kujdestaria e fëmijëve, por shuma e alimentacionit, që sipas gjykatës u vendos duke marrë parasysh të ardhurat e paditësit, por dhe mundësitë e tij reale për të realizuar fitim, dhe nga ana tjetër u konsiderua si kontribut puna dhe kujdesi i të paditurës për edukimin dhe rritjen e fëmijëve.

6. "Fëmija nuk do të humb të drejtën në mbajtje nga prindërit e tij nëse ka lidhur martesë, nëse shkollimi dhe aftësimi i tij profesional vazhdon edhe pas arritjes së moshës madhore, deri në përfundimin e rregullt të shkollimit, por më së voni deri në arritjen e moshës 26 vjeçare, nëse bashkëshorti i tij nuk është në gjendje materiale ta mbajë atë (VSRMev. 408/80, Zb. VSM III odl.2)." ⁷⁶
7. "Fëmija i cili ka fituar paaftësinë e plotë dhe të përhershme për punë pas moshës deri në të cilën i sigurohet e drejta për pensionin familjar, atë të drejtë mund ta realizojnë vetëm nëse paaftësia për punë është shkaktuar para vdekjes së prindërve të tij, të cilët për këtë arsye i kanë siguruar mbajtjen. (VSMU 2408/83 Zb.VSM III odl.66)." ⁷⁷
8. "Babai i fëmijës së mitur, i cili nuk është i punësuar, nuk është i liruar nga obligimi që të paguajë alimentacioni e fëmijës së tij. (OSSHzh. 1236/77, Zb VSM II odl.12)" ⁷⁸
9. "Fëmija, i cili e ka humbur nënën e tij ka të drejtën e kompensimit dëmit(material) për shkak të humbjes së mbajtjes edhe në raste kur nëna e fëmijës nuk ka qenë në marrëdhënie pune, por ka qenë amvise. (VSNGzh 405/77, Zb VSM II odl. 102)." ⁷⁹

⁷⁶ Zendeli Emine, Selamni - Bakiu, Arta, Mickoviq, Dejan, Ristov, Angel, E drejta familjare, Tetovë 2020, f. 329

⁷⁷ Po aty, f. 329

⁷⁸ Po aty, f. 329

⁷⁹ Po aty, f. 329

10. "Kur nëna e ndjerë, përveç shpenzimeve materiale, është përkujdesur personalisht edhe për ruajtjen e paditëses së mitur, duhet të vlerësohet edhe përkujdesja materiale që ia ka dhënë nëna vajzës së saj, dhe gjithë kjo të përlogaritet si shumë sipas së cilës do të vlerësohet kërkesa për kompensimin e dëmit për mbajtjen e humbur. (VSMGzh. 106/77, Zb VSM II odl. 103)"⁸⁰

11. "Aktgjykimi me të cilin është vendosur dhënia e mbajtjes para shkurorëzimit të martesës pushon të vlejë deri në aktgjykimin e plotfuqishëm me të cilin shkurorëzohet martesa e palëve. (VSMRev, 52/86, Zb VSM IV odl.10)." ⁸¹

4.5. Të dhëna nga anketat dhe intervistat e realizuara

Të dhënat e mbledhura janë ndarë në dy pjesë - intervista dhe anketa, dhe do na sjellin një pasqyrë sa më të qartë për temën tonë të cilën po e punojmë.

4.5.1. Intervistat

Për të dhënë një pasqyrë më të mirë e më të qartë në lidhje me temën që e kemi elaboruar, kemi realizur edhe anketa dhe intervista me punëtorë profesional nga fusha e cila e përfshinë temën tonë me qëllim që të pëcjellim edhe rrjedhën e praktikës së kësaj teme në opinion.

1. Intervista e parë është e zhvilluar me përmbauesen Jadranka Jovanovska, që e ushtron veprimtarinë në territorin e Gjykatës themelore Kumanovë, e cila i'u është përgjigjur pyetjeve si më poshtë:

a) A janë të shpeshta rastet e përmbarrimit për ekzekutimin e vendimeve gjyqësore për dhënien e alimentacionit ndaj bashkëshortit/es në RMV?

⁸⁰ Zendeli Emine, Selamni - Bakiu, Arta, Mickoviq, Dejan, Ristov, Angel, E drejta familjare, Tetovë 2020, f. 329

⁸¹ Po aty, f. 335

Në praktikë viteve të fundit ka më shumë shkurorëzime dhe numri i rasteve të përmbarrimit për alimentacion ndaj bashkëshortëve është rritur edhe pse ende nuk është shumë e njohur si lëndë.

- b) A janë të shpeshta rastet e përmbarrimit për ekzekutimin e vendimeve gjyqësore për dhënien e alimentacionit ndaj fëmijëve në RMV?

Po rastet e alimentacionit për fëmijët janë më të shpeshta dhe ka shumë lëndë ku prindi nuk paguan me rregull alimentacionin e caktuar në gjykatë andaj dhe hasim shumë raste të tilla.

- c) Cilat janë mjetet me të cilat ekzekutohet përmbarrimi i së drejtës së mbajtjes dhe ushqimisë dhe a është e vështirë për përmbarruesit një gjë e tillë?

Tek ne nuk kemi pasur raste të këtij lloj përmbarrimi

- d) Me ndryshimet e fundit të Ligjit për përmbarrim, a janë paraparë dispozita përmirësuese dhe lehtësuese në lidhje me përmbarrimin e vendimeve gjyqësore të cilat kanë të bëjnë me zbatimin e së drejtës së alimentacionit?

Me ndryshimet e ligjit nuk janë paraparë dispozita përmirësuese për përmbarrimin e së drejtës së alimentacionit.

2. Intervista e dytë është realizuar me përmbarruesin Igor Antevski, që e ushtron veprimtarinë në territorin e Gjykatës Civile Shkup, i cili i elaboroi pyetjet si në vijim:

- a) A janë të shpeshta rastet e përmbarrimit për ekzekutimin e vendimeve gjyqësore për dhënien e alimentacionit ndaj bashkëshortit/es në RMV?

Në praktikën tonë janë të shpeshta rastet e ekzekutimit të vendimeve gjyqësore, pra për ekzekutimin e detyrimeve ushqimore nga bashkëshorti. Në praktikë, ne kemi një lëndë në muaj.

- b) A janë të shpeshta rastet e përmbarimit për ekzekutimin e vendimeve gjyqësore për dhënien e alimentacionit ndaj fëmijëve në RMV?

Më së shpeshti janë raste që kanë të bëjnë me ekzekutimin e vendimeve gjyqësore për caktimin e fëmijëve në RMV. Për ekzekutimin e alimentacionit për fëmijët që janë jashtë RMV edhe nëse nuk ka.

- c) Cilat janë mjetet me të cilat ekzekutohet përmbarimi i së drejtës së mbajtjes dhe ushqimit dhe a është e vështirë për përmbaruesit një gjë e tillë?

Përmbarimet më së shpeshti kryhen me urdhër për përmbarim në paga dhe kërkesa të tjera monetare në bazë të nenit 141 të Ligjit për përmbarim, në shumën prej $\frac{1}{2}$ e pagës së debitorit, varësisht nga shuma e alimentacionit të përcaktuar me dokumentin përmbarues.

Vështirësitë në mbledhjen e alimentacionit ndodhin kur debitori nuk ka mjete për pagesë (ai nuk është i punësuar, nuk ka pasuri të luajtshme ose të paluajtshme nga e cila mund të mbledhet kërkesa).

- d) Me ndryshimet e fundit të Ligjit për përmbarim, a janë paraparë dispozita përmirësuese dhe lehtësuese në lidhje me përmbarimin e vendimeve gjyqësore të cilat kanë të bëjnë me zbatimin e së drejtës së alimentacionit?


Me ndryshimet në Ligjin për Përmbarim, nuk ka dispozita të veçanta që mundësojnë përmirësimin apo lehtësimin e kërkesës për pagesë të alimentacionit. Nëse debitori i cili është përgjegjës për pagesën së alimentacionit nuk ka mjete nga të cilat mund të paguaj

alimentacionin, kreditorët, pra përfituesi i alimentacionit i ndjekin penalisht për të arritur një efekt për pagesë.

4.5.2. Anketa


Përpos intervistave me përmbauesit e lartëpërmendur në vijim e kemi paraqitur edhe anketën dhe rezultatet nga anketa në të cilën pjesëmarrës ishin 64 persona nga grupmosha dhe profesione të ndryshme, të cilët u janë përgjigjur gjithsej 9 pyetjeve. Përkaj secilës pyetje, janë të paraqitura edhe rezultatet e anketës në përqindje si më poshtë:

1. *A mendoni se ekziston detyrimi ligjor për mbajtje dhe ushqim midis bashkëshortëve ?*




Në këtë pyetje gjithsej 76.6% e të anketuarve u përgjigjigjrn me PO dhe 23.4% u përgjigjen me JO.

2. A mendoni se ekziston detyrim ligjor i prindërve për mbajtje dhe ushqim të fëmijëve?




Nga të anketuarit në këtë pyetje u përgjigjen me 100 % PO, do me thënë që ekziston një detyrim ligjor për alimentacion nga prindërit për fëmijët e tyre.

3. A mendoni se në raste të caktuara ekziston detyrim ligjor i prindërve për mbajtje dhe ushqim të fëmijëve të moshës madhore ?




Pyetjes së lartëpërmendur 75% e të anketuarve i'u përgjigjen me PO dhe 25% e të anketuarve i'u përgjigjen me JO.

4. *A mendoni se ekziston e drejta ligjore për mbajtje dhe ushqim edhe midis partnerëve jashtëmartesorë?*




Të anketuarit u përgjigjen pozitivisht 30.2%, dhe nuk u dakorduan apo dhanë përgjigje negative 69.8%, për çështjen e ekzistimit të drejtës ligjore për bashkëshortët apo partnerët jashtëmartesor.

5. *A mendoni se bashkëshorti i cili është shfrytëzues i alimentacionit në raste të caktuara mund të jetë i padenjë për të shfrytëzuar një të drejtë të tillë edhe pse me ligj ajo e drejtë i takon ?*




Në këtë pyetje u përgjigjen me PO 47.6% të anketuarve dhe me JO 52.4%.

6. *Në rast se dhënësi i alimentacionit humb aftësinë fizike apo psiqike e në këtë rast edhe aftësinë për të dhënie të alimentacionit, a shuhet edhe e drejta e marrësve të alimentacionit?*




Kësaj pyetjeje me PO i'u përgjigjen 54.7% e të anketuarve, ndërsa 45.3% u përgjigjen me JO.

7. *A mendoni se e drejta për mbajtje dhe ushqim (alimentacioni) i takon edhe bashkëshortit (burrit) ?*




78.1% e të anketuarve ishin të mendimit se edhe bashkëshortit i takon e drejta e alimentacionit dhe 21.9% ishin të mendimit se një veprim i tillë nuk i takon burrit.

8. A mendoni se e drejta për alimentacion mund t'i takoj edhe ish bashkëshortit/es?



Të anketuarit në këtë pyetje u përgjigjen me përgjigje pozitive 56.3 % dhe 43.8% dhanë përgjigje negative.

9. Nga 1 deri në 5, sa mendoni që janë të rregullt në zbatim dhënësit e alimentacionit në vendin tonë ?



Në pyetjen e fundit të anketës ku kishte më shumë vlerësime vijuan përgjigjet me notim si më poshtë:

- Me notën 0 e vlerësuan 1.1% e të anketuarve.
- Me notën 1 e vlerësuan 31.3 % e të anketuarve.
- Me notën 2 e vlerësuan 21.9 % e të anketuarve.
- Me notën 3 e vlerësuan 34.4 % e të anketuarve.
- Me notën 4 e vlerësuan 5 % e të anketuarve.
- Me notën 5 e vlerësuan 0 % e të anketuarve.
- Me notën -5 e vlerësuan 1.1% e të anketuarve.
- Kurse në vendin tonë nuk zbatohet aspak dhënia e alimentacionit në mënyrë të rregullt e vlerësuan vetëm 1.1%.

PËRFUNDIME

Tema jonë detyrimi për mbajtje ndaj bashkëshortëve dhe fëmijëve me fokus në legjislacionin e RMV - së ishte një temë e cila kërkonte shumë informata, për të mundur për të arritur deri në përfundimin e duhur, prandaj themi që në aspektin ligjor në Republikën e Maqedonisë së Veriut kjo procedurë dhe kjo e drejt e bashkëshortëve dhe fëmijëve është e rregulluar me dispozitat ligjore, edhe pse në bazë të kohës ka nevojë për të pasur ndryshime, duke vendosur dhe përkufizuar në detaje të drejtat e çdonjërit prej tyre.

Tema jonë ka në gjithsej 4 kapituj duke dhe disa nënkapituj të vendosura brenda saj me të cilat jemi munduar që sado pak të nxjerrim në pah të vërtetat që na rrethojnë në rastet e shkurorëzimeve dhe të drejtat që ju takojnë palëve, qofshin ato bashkëshortët në mes tyre, ose detyrimet e prindërve ndaj fëmijëve të tyre.

Në kapitullin e parë kemi shtjelluar zhvillimin historik të detyrimit për mbajtje duke filluar nga gjeneza e saj, e cila kishte një prejardhje prej kohërave të hershme por duke u manifestuar në forma të ndryshme, por kishte edhe raste kur një veprim i tillë nuk është marr parasysh posaçërisht në divorcin e bashkëshortëve ku burrat i kanë hedhur jashtë grat e tyre dhe duke mos mbajtur asnjë lloj përgjegjësi më për to. Më paskemi vazhduar me historikun e saj në vendet tona gjegjësisht praktikimin e saj në ish – shtetin Jugosllavë, e cila në kohën e saj dispozitat e saja të nxjerra nga kodi civil kanë pasur vlefshmëri për shumë vende të ndryshme si pjesë e ish – shtetit Jugosllavë, kurse me copëtimin e këtij shteti më pas çdonjëri prej shteteve kanë shpallur pavarësinë e tyre dhe me këtë kanë rregulluar edhe kodet e saja civile, penale etj, ku këtë e vërejtëm nga ligji për familje i Republikës së Maqedonisë së Veriut.

Më pas në këtë kapitull kemi sqaruar edhe për parimet themelore të cilat duhet të i kenë bashkëshortët në aspektin financiar me çka do ju mundësohej realizimi më i drejt dhe më i përpiktë i detyrimeve të cilat dalin nga dispozitat ligjore si dhe duke pasur parasysh veçorit e detyrimeve për mbajtje të cilat për tu realizuar duhej të ishin, të mundshme, të caktuara dhe të lejueshme.

Në kapitullin e dytë kemi sqaruar për detyrimet për mbajtje në mes bashkëshortëve si dhe në mes bashkëshortëve dhe fëmijëve sipas legjislacionit të Republikës së Maqedonisë së

Veriut, duke pasur parasysh në rend të parë se bashkëshortët në mes tyre në raste të divorceve kanë obligime dhe detyrime edhe më tej në mes tyre të cilat duhet të realizohen nga pala e cila kërkon të drejtën e saj për të realizuar mbajtjen dhe nga pala tjetër e cila detyrohet për të realizuar këtë të drejtë, dhe për të qenë një veprim i këtillë i pranueshëm duhet të fillohet me kërkesë nga palët dhe e cila vazhdon më tej me përcaktimin dhe kohëzgjatjen e mbajtjes, te të cilat gjykatësi parashihte sasinë e caktuar për mbajtjen e bashkëshortëve në mes tyre dhe kohën e realizimit të kësaj të drejte në mes tyre, pra duke pushuar e drejta e mbajtjes në mes tyre.

Në pjesën e dytë të kapitullit të dytë kemi të bëjmë me detyrimin e mbajtjes nga ana e prindërve ndaj fëmijëve të tyre, ku kemi cekur se mbajtja mundet të jetë ndaj fëmijëve të mitur, të cilët nuk kanë mundësi për të mbijetuar vetëm, si dhe mbajtja ndaj fëmijëve të moshës madhore të cilët për shkak shkollimit të tyre nuk mundën të sigurojnë nevojat e tyre për jetesë, por jo duke kaluar mbi moshën 26 vjeçe, gjithashtu sigurimi i mbajtjes së fëmijëve të tyre edhe në moshën madhore vlen për personat që nuk janë në gjendje të sigurojnë jetesën e tyre për shkak ndonjë sëmundje ose pa aftësi tjetër, atëherë prindërit obligohen të kujdesen për to, deri në tejkalimin e situatës apo gjithë kohën sa janë të gjallë, duke pasur parasysh se edhe këtu përcaktohet sasia apo vlera e mbajtjes që prindërit obligohen të harxhojnë për fëmijët e tyre.

Në kapitullin e tretë kemi sjellë një krahasim me shtet sikurse që janë Republika e Kosovës, Republikës së Shqipërisë dhe asaj të Italisë në dy pikëpamjet sikurse që ishin obligimet dhe të drejtat në mes bashkëshortëve të cilët janë të divorcuar dhe obligimet dhe të drejtat të cilat dalin nga legjislacionet e tyre në mes prindërve dhe fëmijët e tyre. Rregullat të cilat i kishin të vendosura sikurse që ishte, heqja apo pakësimi i mbajtjes, format e ndryshme për përmbushjen e detyrimeve si dhe përcaktimi i mbarimit të detyrimit të mbajtjes.

Në kapitullin e fundit kemi treguar për rolin e gjykatësin dhe gjyqeve në përgjithësi në përmbushjen e detyrimeve të tyre në raste të këtilla sikurse që janë përmbushja e detyrimit nga dy palët, përcaktimi se a ju takon realizimi i kësaj të drejte, analizimi i argumenteve dhe fakteve të shumta deri në ardhjen e një vendimit realizues në mes palëve duke mos e rënduar dhe dëmtuar palën tjetër. Një rol të veçantë luante edhe Qendra për punë sociale në zbatimin e kësaj të drejte në mes prindërve dhe fëmijëve, duke qenë edhe ndërmjetësuese në mes

prindërve dhe fëmijëve, si dhe përcjellja e rasteve të detaje duke propozuar rritjen e detyrimit për mbajtje të fëmijës, për arsye të rritjes së nevojave të fëmijës për jetesë.

Më pas kemi sjellë disa raste nga praktika gjyqësore të cilat na kanë ndihmuar të kemi një pasqyrë më të lehtë se si funksionojnë dispozitat ligjore, dhe në përfundim të kësaj teme kemi sjellë statistika nga anketa dhe intervistat e realizuara ku na japin një pasqyrë më të pastër rreth asaj se si praktikohet dhe në çfarë forme praktikohet alimentacioni, por anketa dha një reflektim shumë më ndryshe posaçërisht në pyetjen e fundit ku me numër 5 nuk e vlerësoi asnjë nga anketuesit, kurse me notën 3 e vlerësuan 34.4 % nga të anketuarit, e cila na tregon edhe se besimi ndaj institucioneve është i dobët ose paraqet mos besim ndaj tyre për praktikimin me dhënies së alimentacioneve në baza ligjore.

Me këtë mund të themi se për realizimin e detyrimit të mbajtjes së bashkëshortëve në mes tyre ose të prindërve dhe fëmijëve, është një praktik e mirë ngase kujdesa në mes tyre mund të jetë shkak për bashkimin e dy palëve, ose edhe nëse kjo nuk arrihet respektohet e drejta e çdonjërit prej tyre.

Disa nga konkluzionet kryesore të këtij punimi janë si vijon:

1. Detyrimi për mbajtje ndaj bashkëshortit/ës dhe fëmijëve është një obligim ligjor i një personi për të siguruar mbështetje financiare për partnerin e tyre dhe fëmijët e tyre. Ky detyrim mund të përcaktohet nëpërmjet vendimeve të gjykatës ose marrëveshjeve të ndërmjetësimit, dhe ai është i ndryshueshëm bazuar në kushtet aktuale të çiftit dhe fëmijëve.
2. Ligjshmëria dhe vlerat e detyrimit për mbajtje ndaj bashkëshortit/ës dhe fëmijëve ndryshojnë në vende të ndryshme dhe mund të përfshijë kritere të tilla si të ardhurat, pasuria, nevojat e fëmijëve, dhe faktorë të tjerë që gjykata ose legjislacioni i aplikojnë.
3. Rregullimi i Marrëdhënieve me Familjen (RMV - së) është një mjedis ligjor që përcakton dhe menaxhon detyrimin për mbajtje në lidhje me bashkëshortët dhe fëmijët. Ky ligj është shpesh i përdorur për të ndihmuar në përcaktimin e detyrimeve financiare të ndryshueshme në raste të ndarjes ose divorcit.

4. Legjislacioni i RMV - së është i rëndësishëm për të mbrojtur të drejtat e fëmijëve dhe partnerëve në rastet e ndarjes së çifteve dhe për të siguruar që ata të kenë mbështetjen dhe resurset e nevojshme për një jetë të qëndrueshme.
5. Detyrimi për mbajtje ndaj bashkëshortit/ës dhe fëmijëve është një përgjegjësi serioze ligjore dhe financiare, dhe mosrespektimi i tij mund të çojë në pasojat ligjore dhe financiare të ndryshme.

BIBLIOGRAFIA

Libra, revista:

1. Abdulla Aliu, Haxhi Gashi, E drejta familjare, Prishtinë, 2007
2. Abdurrahman Kurt, Bursa Sicillerine Göre Osmanlı Ailesi (1839-1876), Bursa 1998,
3. Afrim Osmani, Kodi penal i Republikës së Maqedonisë, Furkan ISM -Shkup, 2010,
4. Aleks Luarasi, Marrëdhëniet familjare në të drejtën zakonore shqiptare, Tiranë 2001,
5. Andrew Borkowski, Paul du Plessis, E drejta romake, Tiranë : UET Press
6. Arsen Janevski, Tatjana Zoroska-Kamilovska, E drejta procedural civile – libri i parë – E drejta kontestimore, Shkup, 2009
7. Arsen Janevski, Tatjana Zoroska-Kamilovska, Gragjansko procesno pravo - kniga treta – Izvrsno pravo, , Skopje, 2011
8. Arta Mandro, E drejta familjare: familja, fëmijët, martesë, bashkëshortët, Tiranë, 2009
9. Arta Mandro-Balili, Arbelina Dedushaj, Albana Metaj-Stojanova, Milena Vasic, Luljeta Aliu (INJECT), Pjesëtimi i pasurisë së përbashkët dhe mbajtja financiare – Ligji dhe praktika gjyqësore në Shqipëri, Kosovë, Mal të Zi, Maqedoni të Veriut dhe Serbi, Prishtinë, 2021
10. Arta Mandro-Balili, E drejta romake, Emal – Tiranë 2007
11. Arta Mandro-Balili, Vjollca Meçaj, Tefta Zaka, Arjana Fullani, E drejta familjare, Tiranë, 2006
12. Arta Mandro-Balili,, E drejta familjare, Kristalina KH – Tiranë 200
13. Blair Marianne D. & Блер Мариен Д. & Merle H. Weiner, & Мерл Х. Вайнер, Меѓународно семејно право : конвенции, статuti и регулаторни материјали, Магор – Скопје, 2009
14. Burrat dhe Gratë në Shqipëri 2019 - Women and man in Albania 2019 / Instituti i statistikave, drejt.bot . Delina Ibrahimaj Tiranë INSTAT 2019
15. Celal Nuri, Kadınlarımız, Istanbul, 1331,
16. Dejan Mickovik, Angel Ristov, Semejno pravo, Stobi Trejd, Skopje, 2015
17. Dr. Abd ar – Rahman bin Abd Al- Kareem Ash- Sheha, Pozita e gruas në Islam – për. European Islamic Research Center.

18. Dr. Sherif Abdel Azīm, Gratë Në Islam kundrejt grave në traditën judeokristiane Miti & realiteti - përktheu : Edin Q. Lohja (Shkodër, Korrik 1996) - Conveying Islamic Message Society Aleksandri 2008.
19. Emine Zendeli, Arta Selmani-Bakiu, Dejan Mickoviq, Angel Ristov, E drejta familjare, Tetovë 2020
20. Fahrudin Ebibi, Irfan Abazi, Taxhedin Bislimi, Jusuf Zimeri, E drejta familjare në islam, Shkup, 2004
21. Fatmira Musaj, Gruaja në Shqipëri : (1912-1939), Akademia e Shkencave e Republikës së Shqipërisë - Instituti i Historisë, Tiranë 2002
22. Feridun Merter, Köy Ailesinde Meydana Gelen Değişmeler, Ankara 1990
23. Francesco Galgano, E drejta Private, Luarasi, Tiranë, 2006,
24. Gale Galev, Jadranka Dabovik-Anastasovska, Obligaciono pravo, Skopje, 2012
25. Genişbilgi için bkz. M. Akif Aydın, İslam Osmanlı Aile Hukuku , İstanbul 1985,
26. Giovanni Bonilini, Komentari i të drejtës familjare, Tiranë, 2004
27. Giovanni Bonilini, Manual i së drejtës familjare, Tiranë, 2005
28. Giovanni Bonilini, përkth. Anila Ismaili, Alketa Ylli, Manual i së drejtës familjare, Tiranë 2005
29. GRATË DHE BURRAT NË KOSOVË 2014-2015 - Agjencia e Statistikave të Kosovës (ASK) Dhjetor 2016.
30. Hamdi Podvorica, E drejta familjare, Prishtinë, 2005
31. Hamdi Podvorica, E drejta familjare, Prishtinë, 2010.
32. Hamdi Podvorica, E drejta trashëgimore, Prishtinë, 2009
33. Hamdi Podvorica, E drejta familjare, Prishtinë 2005
34. Hamude Abdulati, Struktura familjare në Islam – Logos A Shkup 1995
35. Hasan Jashari, Familja dhe bashkësia, Tetovo - SEE University 2006
36. Jordan Daci, Të drejtat e njeriut, Luarasi – Tiranë 2006
37. Jusuf Rabuburet, Martesa, paratë dhe divorci në shoqërinë mesjetare islamike, Qendra e Trashëgimisë për Kërkime dhe Studime.
38. K. Lipstein, The Reception of Western Law in Turkey, Annales de la Faculte de droit d Stamboll, no. 6/ 1956

39. Kinalızâde Ali Efendi, Devlet ve Aile Ahlakı, Hazırlayan Ahmet Kahraman, Hüseyin Öztürk, Kinalızâde Ali Çelebi'de Aile, Ankara 1990,
40. Kirill Cavdar, Cvetanka Siljanoska-Kostadinovska, Komentar na Zakonot za semejstvo, Shkup 2013,
41. Liljana Spirovik-Trpenovska, Dejan Mickovik, Angel Ristov, Semejno pravo, Kulturna Ustanova Blesok, Skopje, 2013
42. Liljana Spirovik-Trpenovska, Nasledno pravo, Skopje, 2009
43. Micković, D., Ristov, A., Bračni ugovor u makedonskom i uporednom pravu, Pravni život, Beograd, 2012.
44. Mickovik, D., Ristov, A., Porodično nasilje u makedonskom kaznenopravnom i porodičnopravnom zakonodavstvu, Porodično nasilje, Beograd, 2012.
45. Mickovik, D., Ristov, A., The Legal Regulation of the Nonmarital Cohabitation in the Macedonian Family Law, International Survey of Family Law, 2012.
46. Mile Hadzivasilev, Semejno pravo, Skopje, 1987
47. Muhamed Ahmed Ken'an Elementet themelore të jetës bashkëshortore. Gostivar, 2004
48. Muhamed Ahmed Kenan, El – Kalem, Elementet themelore te jetës bashkëshortore, Gostiver 2004
49. Muhamed Rashid Rida, Të drejtat e gruas në islam, Nektari - Tiranë, 2006
50. Muhammad A. El-Khalas, Qaddafi: His ideology in Theory and Practise, Brattleboro, Vermont: Amana Books, 1986,
51. Nerxhivane Dauti, E drejta e detyrimeve: pjesa e përgjithshme dhe e veçantë, Prishtinë, 2001
52. Prof. Dr. Bekir Topallogllu, Gruaja në Islam, Stamboll, 1997
53. Rifat Özdemir, "Tokat'ta Ailenin Sosyo-Ekonomik Yapısı (1771-1810), "Türk Tarihinde ve Türk Kültüründe Tokat Sempozyumu (2-6 Temmuz 1986), Ankara 1987
54. Safiye Ünüvar, Saray Hatıralarım, İstanbul 1964
55. Şemseddin Sami, Kadınlar, İstanbul 1311,
56. Sonila Omari, E drejtë familjare, Tiranë, 2007
57. Sherif Deari, E drejta familjare sipas jurisprudencës islame, Gostivar, 1995

58. Shtjefën Gjeçovi, Editor Kanuni i Lekë Dukagjinit, Shtëpia Botuese Kuvendi Tiranë 1998
59. W.S.Goode, World Revolution and Family Patterns, New York 1968
60. Wastermarck, Edvard Alexander – The history of human marriage, New York; the allerton book co... bot. V vëll. III 1992
61. Yaşar Kutluay, Hüseyin Atay; Kur'an-ı Kerim ve Türkçe Anlamı, Ankara 1983.
62. Yasaroglu, M. Kamil, Pakistan'da Islâm Ceza Hukuku'nun Kanunlaştırılması, Istanbul, 1996
63. Zainab Al – Alwanim, Familja në qëllimet e Sheriatit: Të lexuarit në lidhje me martesën dhe çështjet e divorcit në Amerikë - 2013
64. Дејан Мицковиќ, Ангел Ристов, Закон за семејството, Стоби трејд – Скопје 2015
65. Дејан Мицковиќ, Семејството во Европа : XVI-XXI век, Културна Установа Блесок, 2008
66. Кирил Чавдар, Цветанка Силјаноска Костадиновска,, Законот за семејството: коментари, судска практика, предметен регистар, примери за практична примена, придружни прописи и литература, Агенција Академик – Скопје 2013
67. Љиљана Спировиќ Трпеновска, & Дејан Мицковиќ, & Ангел Ристов, Семејно право, Културна Установа Блесок, 2013
68. Мицковиќ, Д., „Правното регулирање на вонбрачната заедница“, Правник, Здружение на правници на РМ, бр. 195-196, 2008.
69. Мицковиќ, Д., Вонбрачните деца и родителското право во европските земји, Годишник на Правниот факултет во Скопје во чест на проф.Борислав Благоев, Правен факултет во Скопје, 2007.
70. Мицковиќ, Д., Кодификација на семејното право во европските земји, Кодификација на Македонското трговско и граѓанско право, Ману, Скопје 2009.
71. Мицковиќ, Д., Конзервативците против либералите: Конфликтот околу семејните вредности во европските земји, Зборник на Правниот факултет „Јустинијан Први“ во Скопје во чест на проф.Томислав Чокревски, Правен факултет „Јустинијан Први“ во Скопје, 2010.
72. Мицковиќ, Д., Од црковните кон световните норми: Еволуција на брачното право во Европа, Зборник на Правниот факултет „Јустинијан Први“ во Скопје во чест на проф.Панта Марна,Правен факултет „Јустинијан Први“ во Скопје, 2007.

73. Мицковиќ, Д., Ристов, А., „Кодификација на граѓанското право во Европа – утопија или реалност“ Зборник на Правниот факултет „Јустинијан Први“ во Скопје во чест на проф. Петар Манговски, Правен факултет „Јустинијан Први“ во Скопје, 2011.
74. Мицковиќ, Д., Ристов, А., „Кодификација на семејното право во Република Македонија“ Зборник радова – Владавина права и правна држава у региону, Универзитет у источном Сарајеву Правни факултет, Источно Сарајево, 2014.
75. Мицковиќ, Д., Ристов, А., „Промените во семејството и реформите во семејното право во Европските земји“, Зборник на Правниот факултет „Јустинијан Први“ во Скопје во чест на проф. Наум Гризо, Правен факултет „Јустинијан Први“ во Скопје, 2011.
76. Мицковиќ, Д., Ристов, А., „Реформите во семејното и наследното право и ингеренциите на нотарите“ Редовно стручно советување на нотарите од Република Македонија 11-13 ноември 2011 година, публикуван во стручното списание, НОТАРИУС, Скопје, декември 2011.
77. Мицковиќ, Д., Ристов, А., Положбата на брачниот другар во македонското и споредбеното наследно право, Зборник на Правниот факултет „Јустинијан Први“ во Скопје во чест на проф. Тодор Пеливанов, Правен факултет „Јустинијан Први“ во Скопје, 2012.
78. Мицковиќ, Д., Семејното право во земјите на Европската Унија: од монистички кон плуралистички концепт на семејството, Зборник на Правниот факултет „Јустинијан Први“ во Скопје во чест на проф. Миле Хаџивасилев Вардарски, Правен факултет „Јустинијан Први“ во Скопје, 2004.
79. Мицковиќ, Д., Семејството во Европа XVI-XXI век, Блесок, Скопје, 2008.
80. Мицковиќ, Д., Францускиот Устав од 1791 година и договорната концепција за бракот, Зборник на Правниот факултет „Јустинијан Први“ во Скопје во чест на про. Владимир Митков, Правен факултет „Јустинијан Први“ во Скопје, 2010.
81. Спировиќ Трпеновска, Љ., „Аналогија на вонбрачната со брачната заедница“ Зборник во чест на проф. Борислав Благов, Скопје, 2007.

82. Спировиќ Трпеновска, Љ., „Карактеристики на семејното законодавство во Република Македонија“, Семејното законодавство на Република Македонија, Реферати за Републичко советување, Врховен суд на Република Македонија, Скопје, 1994.
83. Спировиќ Трпеновска, Љ., Семејно право, Правен факултет „Јустинијан Први“ Скопје, 2008.
84. Спировиќ-Трпеновска, Љ., Бракот и семејството во Бразил, Годишник на Правниот факултет – Скопје, Скопје, 1990/1991.
85. Спировиќ-Трпеновска, Љ., Семејно право, Студентски збор, Скопје, 2004.

Akte ligjore, kode:

1. Ligji themelor për martesë, Gazeta zyrtare e RSFJ – së, nr. 304 të datës 23.04.1965
2. Kodi Civil Italian, Ligj Nr. 262, dt. 16.03.1942, (i përditësuar),
3. Kodi i Familjes i Shqipërisë, Ligj Nr. 9062, dt. 08.05.2003, ndryshuar me Ligjin Nr. 134/2015, (i përditësuar),
4. Ligji Nr. 601, dt.18.05.1948 “Mbi Martesën” i Jugosllavisë, (1948)
5. Ligji për Familjen i Kosovës, Ligj Nr.32/2004
6. Ligji për Familjen i RMV, Ligj Nr. 80, dt. 30.12.1992
7. Ligji për Marrëdhëniet Detyrimore i RMV (Gazeta Zyrtare nr.18/2001)
8. Ligji për Martesën i Republikës Socialiste të Maqedonisë, (Gazeta Zyrtare e RSM, nr.35/1973)
9. Ligji për mbrojtje sociale i RMV-së
10. Ligji për Përmbarim i RMV (Gazeta Zyrtare, nr.72, dt.12.04.2016)
11. Ligji për Trashëgiminë i RMV, (GazetaZyrtare, nr. 47/1996)
12. Ligji për Mundësi të Barabarta për Gratë dhe Burrat i RMV (Gazeta Zyrtare Nr. 6, dt. 13.01.2012)
13. Ligji Themelor për Martesën i RFJP, (1946)
14. KODI I FAMILJES I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË LIGJ Nr. 9062, datë 8.5.2003
15. KODI PENAL I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË LIGJ Nr.7895, datë 27.1.1995
16. Kushtetuta e Republikës së Maqedonisë, 1991

17. Ligji për familje (Gazeta zyrtare e RM, Nr.38/2004)
18. КРИВИЧЕН ЗАКОНИК („Службен весник на Република Македонија" број 80/99..)
19. Konventa për mbrojtjen e të drejtave dhe lirive themelore të njeriut
20. Deklarata për Eliminimin e të Gjitha Formave të Dhunës ndaj Gruas
21. Ligji për familje në Republikën e Maqedonisë së Veriut, Gazeta zyrtare numër 153 i datës 20.10.2014
22. Ligji për mbrojtje të fëmijëve, (Gazeta zyrtare e RMV, nr. 23/13, 12/14, 44/.14, 10/15, 25/15, 150/15, 192/15, 27/16, 163/17, 21/18, 198/18, 104/19, 146/19, 275/19, 311/20, 294/21, 150/22)
23. Konventa mbi të drejtat e fëmijës, 20.11.1989

Burime nga Interneti:

1. <https://netpress.com.mk/hrvatite-se-razveduvaat-za-da-ne-plakjaat-kredit/>
2. <https://www.pravdiko.mk/karakteristiki-na-izdrshkata-vo-makedonskoto-zakonodavstvo/>
3. <https://portal.tlas.org.al/sq/sherbimet/detyrim-ushqimor>
4. <http://www.legalsl.com/en/alimony-in-italy-italian-family-law.htm>
5. https://e-justice.europa.eu/content_maintenance_claims-47-it-en.do?member=1